REPUBLIKA E SHQIPËRISË

USHTRIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Viti i 82-të i botimit Nr. 47 (828003) Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes E premte, 27 nëntor 2026



SHQIPËRIA, ZËRI I SIGURISË RAJONALE NË KONFERENCËN E 14-TË TË DECI-t

» faqe 3



GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI NDERON ME "MEDALJEN E NDERIT" KOMANDANTIN E FSK-SË, GJENERALLEJTËNANT BASHKIM JASHARIN

Një vlerësim për kontributin në forcimin e bashkëpunimit ushtarak Shqipëri–Kosovë dhe në zhvillimin e kapaciteteve të përbashkëta. Një marrëdhënie e ndërtuar mbi historinë, sakrificën, vlerat e përbashkëta dhe vizionin euroatlantik merr kuptim të veçantë kur përkthehet në bashkëpunim konkret institucional dhe ushtarak. Në këtë frymë u zhvillua ceremonia e nderimit të komandantit...

faqe 2



FARSH–FSK, BASHKËPUNIM MË I THELLUAR NË EDUKIMIN DHE ZHVILLIMIN PROFESIONAL

Gjeneralmajor Ferdinant Dimo zhvilloi një vizitë zyrtare në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së. Bashkëpunimi ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës vijon të konsolidohet dhe të zgjerohet në fusha me rëndësi të veçantë për zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe institucionale. Në këtë kuadër, Gjeneralmajor Ferdinant Dimo...

faqe 4



28–29 NËNTORI: DY DITË, NJË KUJTESË, NJË SHQIPËRI

Nga flamuri që u ngrit në Vlorë te flamuri që valëvitet sot mbi institucionet e shtetit, historia shqiptare ka ditë që nuk mjafton t'i kujtosh. Ato duhet t'i përjetosh, t'i kuptosh dhe t'ua përcjellësh brezave. 28 dhe 29 Nëntori janë pikërisht të tilla. Data të caktuara nuk qëndrojnë në kalendar vetëm për përcaktim kohor, ato bëhen pjesë e ndërgjegjes së një kombi, sepse mbartin brenda tyre sakrifica, ëndrra, beteja, humbje, fitore dhe shpresën për të ardhmen...

faqe 5

Ministri i Mbrojtjes Nufi: Siguria e informacionit, domosdoshmëri strategjike përballë kërcënimeve të reja

Shqipëria dhe Kosova synojnë të thellojnë bashkëpunimin në fushën e sigurisë kibernetike

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, mori pjesë në konferencën "Sfidat e Sigurisë së Informacionit në realitetin e TIK", të organizuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar në Shqipëri dhe Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar në Kosovë.

Konferenca u fokusua në sfidat që sjell zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe në nevojën për forcimin e mekanizmave të sigurisë së informacionit përballë një mjedisi gjithnjë e më kompleks kërcënimesh.

Në fjalën e tij, ministri Nufi theksoi se përballë kërcënimeve të reja, investimi në teknologji, zhvillimi i kapaciteteve, inovacioni dhe bashkëpunimi ndërinstitucional janë bërë domosdoshmëri strategjike.

Sipas ministrit, Shqipëria dhe Kosova duhet ta çojnë bashkëpunimin në fushën e sigurisë kibernetike në një nivel më konkret dhe më ambicioz, duke u mbështetur në shkëmbimin e ekspertizës, konsultimin e rregullt, zhvillimin e ushtrimeve të përbashkëta dhe krijimin e kapaciteteve të ndërveprueshme.

"Përballë kërcënimeve gjithnjë e më komplekse, investimi në teknologji, zhvillimi i kapaciteteve, inovacioni dhe bashkëpunimi ndërinstitucional nuk janë zgjedhje, por domosdoshmëri strategjike", - nënvizoi ministri Nufi.

Ai vuri në dukje gjithashtu rëndësinë e një përgjigjeje të koordinuar ndaj kërcënimeve kibernetike, të cilat nuk kufizohen nga kufijtë shtetërorë. Në këtë kontekst, partneriteti dhe bashkëpunimi mes institucioneve shqiptare dhe kosovare marrin një rëndësi të veçantë për





mbrojtjen e sistemeve dhe informacionit të ndjeshëm.

Ministri Nufi theksoi se kërcënimet nuk njohin kufij dhe, për këtë arsye, as përgjigjja ndaj tyre nuk mund të jetë e fragmentuar. Koordinimi, partneriteti dhe një vizion i përbashkët duhet të jenë baza e përpjekjeve për garantimin e sigurisë së informacionit dhe forcimin e qëndrueshmërisë kibernetike.

Konferenca shërbeu edhe si një mundësi për shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizës ndërmjet institucioneve të Shqipërisë dhe Kosovës, në një fushë që po merr rëndësi gjithnjë e më të madhe për sigurinë kombëtare dhe atë rajonale.

Në kushtet kur teknologjia e informacionit është bërë pjesë integrale e funksionimit të institucioneve shtetërore, mbrojtja e informacionit dhe e infrastrukturave kritike kërkon kapacitete të avancuara, personel të specializuar dhe bashkëpunim të vazhdueshëm.

Në këtë drejtim, bashkëpunimi Shqipëri–Kosovë në sigurinë kibernetike shihet si pjesë e një qasjeje më të gjerë për forcimin e sigurisë së të dy vendeve, stabilitetit rajonal dhe orientimit të tyre.

GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI NDERON ME "MEDALJEN E NDERIT" KOMANDANTIN E FSK-së, GJENERALLEJTËNANT BASHKIM JASHARIN

Një vlerësim për kontributin në forcimin e bashkëpunimit ushtarak Shqipëri–Kosovë dhe në zhvillimin e kapaciteteve të përbashkëta

Një marrëdhënie e ndërtuar mbi historinë, sakrificën, vlerat e përbashkëta dhe vizionin euroatlantik merr kuptim të veçantë kur përkthehet në bashkëpunim konkret institucional dhe ushtarak. Në këtë frymë u zhvillua ceremonia e nderimit të komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, i cili e nderoi atë me **"Medaljen e Nderit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë"**.

Vlerësimi për gjenerallejtënant Bashkim Jasharin përbën shprehje të mirënjohjes për kontributin e tij në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), si dhe për angazhimin e tij në rritjen e ndërveprueshmërisë, shkëmbimin e përvojave profesionale dhe zhvillimin e kapaciteteve ushtarake.

Në ceremoninë e dekorimit, gjenerallejtënant Arben Kingji vlerësoi rolin e Komandantit të FSK-së në konsolidimin e marrëdhënieve ndërmjet dy institucioneve të mbrojtjes, duke e konsideruar këtë bashkëpunim një komponent të rëndësishëm të sigurisë së përbashkët dhe stabilitetit rajonal.

Një medalje për një kontribut të përbashkët

"Medalja e Nderit" nuk ishte vetëm një vlerësim për një personalitet të lartë ushtarak. Ajo përcolli edhe një mesazh mirënjohjeje për të gjithë efektivët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, për profesionalizmin, përkushtimin dhe frymën e bashkëpunimit të treguar ndër vite. Bashkëpunimi FARSH–FSK është shtrirë në një gamë të gjerë fushash, duke përfshirë arsimin dhe trajnimin ushtarak, stërvitjet e përbashkëta, shkëmbimin e ekspertizës, zhvillimin e kapaciteteve dhe rritjen e ndërveprueshmërisë. Përmes këtyre angazhimeve, dy institucionet kanë krijuar ura të qëndrueshme bashkëpunimi profesional, duke kontribuuar në forcimin e kapaciteteve të tyre dhe në përgatitjen për sfidat e sigurisë.

Në këtë kuadër, vlerësimi për gjenerallejtënant Jasharin merr një rëndësi të veçantë, pasi lidhet drejtpërdrejt me përpjekjet për ta çuar bashkëpunimin ushtarak në nivele gjithnjë e më të larta.

Shqipëria dhe Kosova, një vizion i përbashkët euroatlantik

Në themel të marrëdhënieve ndërmjet FARSH-së dhe FSK-së qëndrojnë lidhje që shkojnë përtej bashkëpunimit institucional. Shqipëria dhe Kosova ndajnë një histori të përbashkët, kujtesën e sakrificës dhe aspiratën për një hapësirë euroatlantike të sigurt dhe të qëndrueshme.

Në këtë frymë, gjenerallejtënant Arben Kingji nënvizoi vendosmërinë për vijimin dhe thellimin e partneritetit në fushën e mbrojtjes, përmes bashkëpunimit institucional,







arsimor dhe humanitar. Ky vizion e vendos bashkëpunimin Shqipëri–Kosovë në një perspektivë më të gjerë, ku zhvillimi i kapaciteteve ushtarake, profesionalizimi i personelit dhe ndërveprueshmëria marrin rëndësi të veçantë për sigurinë rajonale.

Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, marrëdhënia me Forcën e Sigurisë së Kosovës mbetet një nga partneritetet më të rëndësishme në rajon. Ajo ndërtohet çdo ditë përmes komunikimit të drejtpërdrejtë, trajnimeve, shkëmbimit të përvojave dhe angazhimeve të përbashkëta.

Një partneritet që shkon drejt së ardhmes

Dekorimi i Komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, ishte edhe një moment reflektimi mbi rrugën e përbashkët të dy institucioneve ushtarake. Medalja simbolizon mirënjohjen për atë që është arritur, por njëkohësisht shërben si një nxitje për të vijuar punën. Bashkëpunimi ushtarak Shqipëri–Kosovë nuk mbetet vetëm në nivelin e marrëdhënieve dypalëshe; ai lidhet me objektivin e përbashkët për një rajon më të sigurt dhe me përpjekjet për forcimin e kontributit në arkitekturën euroatlantike të sigurisë.

Në këtë rrugëtim, profesionalizmi, besimi dhe solidariteti mes Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës mbeten vlera themelore.

Një medalje për një komandant, por në thelb një mirënjohje për një bashkëpunim që tashmë është shndërruar në një urë të qëndrueshme mes dy institucioneve dhe dy vendeve, në shërbim të sigurisë, paqes dhe stabilitetit në rajon.

STAFI
ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor
Redaktore/ korrektore: Suela **HODA**
Graphic Designer: Afërdita **HYSAJ**
ADRESA:
Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"







SHQIPËRIA, ZËRI I SIGURISË RAJONALE NË KONFERENCËN E 14-të TË DECI-t

Presidenti i RSH, Sh. T. z. Bajram Begaj: Paqja ruhet duke investuar në siguri, duke forcuar aleancat dhe duke vepruar së bashku



Ministri i Mbrojtjes z. Ermal Nufi: Siguria jonë kolektive varet nga aftësia për të bashkëpunuar, koordinuar dhe vepruar së bashku

Shqipëria u bë mikpritëse e Konferencës së 14-të të Shefave të Shtabeve të Përgjithshëm të vendeve anëtare të Iniciativës për Bashkëpunim në Mbrojtje – DECI (Defence Cooperation Initiative), një forum i rëndësishëm i bashkëpunimit ushtarak rajonal dhe evropian, që synon forcimin e sigurisë, rritjen e ndërvepruesmërisë dhe zhvillimin e kapaciteteve të përbashkëta të mbrojtjes.

Konferenca u zhvillua nën kujdesin e veçantë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji, dhe me bashkëdrejtimin e zëvendësshefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Italisë, gjenerallejtënant Luigi Del Bene.

Në ceremoninë e hapjes morën pjesë Presidenti i Republikës së Shqipërisë dhe njëherazi Komandanti i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Sh. T. z. Bajram Begaj, ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, si dhe drejtuesit më të lartë ushtarakë të vendeve pjesëmarrëse në DECI.

Në Tiranë u mblodhën shefat e Shtabeve të Përgjithshëm të Austrisë, Kroacisë, Hungarisë, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Rumanisë dhe Sllovenisë, së bashku me përfaqësues të lartë të Italisë dhe drejtues të strukturave e misioneve ndërkombëtare të sigurisë. Në konferencë morën pjesë gjithashtu përfaqësues të Komandës së Bashkuar Aleate në Napoli, Komandanti i KFOR-it, Komandanti i misionit EUFOR-ALTHEA në Bosnje dhe Hercegovinë, Komandanti i Forcave Shumëkombëshe Tokësore në Itali dhe përfaqësues të Kolegjit të Mbrojtjes Italiane.

Prania e këtyre figurave të larta politike dhe ushtarake i dha konferencës një dimension të veçantë strategjik, duke e kthyer Tiranën në një pikë takimi për diskutimin e sfidave të sigurisë dhe të së ardhmes së bashkëpunimit ushtarak në rajon.

Presidenti Bajram Begaj: Siguria nuk garantohet e vetme

Në fjalën e tij përshëndetëse, Presidenti i Republikës, Sh. T. z. Bajram Begaj, e vendosi bashkëpunimin rajonal në qendër të përballimit të sfidave të reja të sigurisë. Duke iu referuar realitetit të sotëm të sigurisë në Evropë, zhvillimeve të luftës në Ukrainë dhe tensioneve e konflikteve në hapësira të tjera. Kreu i Shtetit theksoi se kërcënimet tradicionale tashmë bashkëjetojnë me rreziqe të reja, të tilla si sulmet kibernetike, ndërhyrjet hibride, dezinformimi dhe cenimi i infrastrukturës kritike.

“Kërcënimet tradicionale bashkëjetojnë me rreziqe të reja: sulmet kibernetike, ndërhyrjet hibride, dezinformimin dhe cenimin e infrastrukturës kritike. Në këto kushte, për të gjitha vendet, pavarësisht madhësisë apo kapaciteteve që ato kanë, siguria mbetet prioritet strategjik dhe ajo nuk mund të garantohet e vetme”, – deklaroi Presidenti Begaj.

Sipas tij, siguria e vendeve varet gjithnjë e më shumë nga aftësia për të bashkëpunuar, për të parandaluar kërcënimet dhe, kur është e nevojshme, për t’iu përgjigjur atyre së bashku. Pikërisht në këtë kontekst, Presidenti vlerësoi rëndësinë e DECI-t si një platformë që mund të kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit dhe të sigurisë rajonale.

Duke vlerësuar progresin e arritur ndër vite, Presidenti Begaj nënvizoi nevojën që bashkëpunimi të shkojë më tej, veçanërisht në shkëmbimin e teknologjive dhe ekspertizës, mbrojtjen nga sulmet kibernetike, modernizimin e kapaciteteve ushtarake, sigurinë detare dhe zhvillimin e infrastrukturës strategjike.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua Ballkanit Perëndimor, ku stabiliteti dhe siguria mbeten elemente të rëndësishme të arkitekturës evropiane të sigurisë.

Presidenti Begaj theksoi se progresi i bërë në rajon është i rëndësishëm, por siguria nuk mund të konsiderohet ende e konsoliduar. Në këtë kuadër, ai nënvizoi rëndësinë e një bashkëpunimi gjithnjë e më gjithëpërfshirës dhe të përfshirjes së Kosovës në arkitekturën rajonale të sigurisë.

“Besoj se forcimi i arkitekturës rajonale të sigurisë kërkon një bashkëpunim gjithnjë e më gjithëpërfshirës, ku edhe Kosova duhet të ketë vendin dhe kontributin e saj. Dhe pse jo, një ditë të jetë anëtare e këtyre iniciativave, por edhe anëtare e Aleancës”, – u shpreh Kreu i Shtetit.

Në këtë kuadër, Presidenti vlerësoi rolin e KFOR-it në Kosovë dhe të strukturave të tjera ndërkombëtare të sigurisë në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon.

Në përmbyllje të mesazhit të tij, Presidenti Begaj përcolli një mesazh të qartë për përgjegjësinë që shoqëron sigurinë kolektive:

“Paqja nuk ruhet vetëm duke thënë se e dëshirojmë atë; paqja ruhet duke investuar, duke investuar në siguri, duke investuar për të forcuar aleancat, duke investuar për të vepruar së bashku.”

Ministri i Mbrojtjes Nufi: Nga dialogu te veprimi konkret

Në të njëjtën linjë strategjike, ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi, vlerësoi rëndësinë e bashkëpunimit ushtarak dhe koordinimit rajonal përballë një mjedisi sigurie gjithnjë e më kompleks.

Ministri Nufi theksoi se zhvillimet në Evropë, lufta në Ukrainë, kërcënimet hibride dhe cenueshmëria kibernetike kanë treguar qartë se sfidat e sotme të sigurisë nuk mund të përballohen nga asnjë shtet i vetëm.

“Siguria nuk mund të trajtohet më vetëm përmes përpjekjeve kombëtare. Qëndrueshmëria jonë kolektive varet nga aftësia për të bashkëpunuar, koordinuar dhe vepruar së bashku. Kjo është pikërisht vlera strategjike e nismës për bashkëpunimin në mbrojtje”, – theksoi ministri Nufi.

Ai nënvizoi se bashkëpunimi mes vendeve anëtare duhet të shkojë përtej dialogut dhe të prodhojë rezultate të prekshme në fushën e mbrojtjes.

“Sot, ambicia jonë duhet të jetë ta çojmë këtë bashkëpunim edhe më tej. Besoj fuqimisht se duhet të shkojmë përtej dialogut dhe ta shndërrojmë mirëkuptimin tonë të përbashkët në rezultate konkrete operacionale: ndërvepruesmëri më të fortë, planifikim të koordinuar, shërvitje të përbashkëta, edukim ushtarak më efektiv dhe forca të afta për të vepruar së bashku në mjedise komplekse dhe sfiduese”, – deklaroi ai.

Duke iu referuar kontributit të Shqipërisë në misionet e drejtuara nga NATO dhe në misionet shumëkombëshe, përfshirë KFOR-in në Kosovë, ministri Nufi e cilësoi këtë angazhim si dëshmi të bindjes së Shqipërisë se stabiliteti në rajon është i pandashëm nga siguria e hapësirës më të gjerë euroatlantike.

“Ballkani Perëndimor nuk ndodhet në periferi të sigurisë evropiane. Ai është pjesë përbërëse e saj!”, – theksoi Ministri, duke shtuar se ruajtja e stabilitetit, forcimi i besimit rajonal dhe avancimi i integrimit euroatlantik duhet të mbeten përparësi strategjike të përbashkëta.

Ministri Nufi nënvizoi gjithashtu se DECI duhet të plotësojë dhe përforcojë përpjekjet e NATO-s dhe Bashkimit Evropian, pa dubluar strukturat ekzistuese.

Në këtë drejtim, Shqipëria, sipas tij, mbetet e angazhuar për të kontribuar aktivisht në këtë përpjekje të përbashkët, duke thelluar ndërlidhjen operacionale dhe duke garantuar që Forcat e Armatosura të jenë gjithnjë e më të përgatitura për sfidat e së nesërmes.

SHSHPFA, gjenerallejtënant Kingji: Partneriteti të kthehet në rezultate, bashkëpunimi në veprim

Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, organizimi i kësaj konference ishte një nder, por njëkohësisht edhe një përgjegjësi e veçantë. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji, vlerësoi pjesëmarrjen e drejtuesve më të lartë ushtarakë të vendeve anëtare dhe të strukturave ndërkombëtare të sigurisë, duke e cilësuar konferencën si një mundësi të rëndësishme për shkëmbimin e pikëpamjeve dhe forcimin e bashkëpunimit.

Në përmbyllje të punimeve, gjenerallejtënant Kingji shprehu mirënjohjen për lidershipin ushtarak të Forcave të Armatosura të Italisë, për partneritetin dhe mbështetjen e vazhdueshme, si dhe për të gjitha delegacionet pjesëmarrëse.

Diskutimet u përqendruan në tri prioritete kryesore: **sigurinë dhe stabilitetin rajonal, bashkëpunimin ushtarak dhe përfshirjen e DECI-t në organizatat ndërkombëtare**.

Sipas gjenerallejtënant Kingjit, këto diskutime rikonfirmuan rëndësinë e unitetit, besimit të ndërsjellë dhe veprimit të përbashkët.

“Për Forcat e Armatosura organizimi i kësaj konference ishte një nder dhe përgjegjësi e veçantë. Shqipëria mbetet e palëkundur në angazhimin e saj ndaj vlerave euroatlantike, paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal, duke e kthyer partneritetin në rezultate konkrete dhe bashkëpunimin në veprim”, – u shpreh gjenerallejtënant Kingji.

Një moment i veçantë i konferencës ishte mirëpritja zyrtare e Rumanisë si anëtarja më e re e DECI-t. Zgjerimi i kësaj nisme dëshmon interesin në rritje për bashkëpunimin rajonal dhe për krijimin e mekanizmave që rrisin ndërvepruesmërinë dhe aftësinë për të vepruar së bashku.

DECI, një platformë që forcon bashkëpunimin rajonal

Iniciativa për Bashkëpunim në Mbrojtje – DECI – u krijua në vitin 2013 me nismën e Italisë, me pjesëmarrjen fillestare të Shqipërisë, Italisë, Austrisë, Kroacisë, Sllovenisë dhe Hungarisë. Më pas, nismës iu bashkuan Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, ndërsa Rumania u mirëprit si anëtarja më e re.

Qëllimi i DECI-t është promovimi i bashkëpunimit rajonal dhe evropian në fushën e mbrojtjes, përmes përcaktimit të linjave të përbashkëta të veprimit dhe zhvillimit të projekteve që synojnë rritjen e stabilitetit, forcimin e ndërvepruesmërisë dhe zhvillimin e kapaciteteve të vendeve anëtare.

Bashkëpunimi shtrihet në pjesëmarrjen e përbashkët në operacionet ndërkombëtare, projektet tekniko-ushtarake, aktivitetet e trajnimit dhe edukimit, si dhe në fusha të tjera me interes të përbashkët.

Konferenca e 14-të e Shefave të Shtabeve të Përgjithshëm dëshmoi se DECI po synon një bashkëpunim gjithnjë e më praktik, në një kohë kur mjedisi i sigurisë kërkon jo vetëm koordinim politik, por edhe kapacitete ushtarake të ndërvepruesme, gatishmëri dhe aftësi për të vepruar së bashku.

Shqipëria, nga mikpritëse në kontribuuese aktive

Për Shqipërinë, kjo konferencë ishte më shumë se një aktivitet i rëndësishëm diplomatik dhe ushtarak. Ajo ishte një mundësi për të afirmuar rolin e vendit në sigurinë rajonale dhe euroatlantike dhe për të përcjellë një mesazh të qartë: siguria e Ballkanit Perëndimor është pjesë e pandashme e sigurisë evropiane dhe euroatlantike.

Përmes pjesëmarrjes në NATO, kontributit në misionet dhe operacionet shumëkombëshe, angazhimit në KFOR dhe bashkëpunimit me partnerët rajonalë e ndërkombëtarë, Shqipëria vijon të dëshmojë se është jo vetëm përfituese, por edhe kontribuuese aktive në sigurinë kolektive.

Në këtë kuadër, DECI përbën një tjetër hapësirë ku partneriteti mund të shndërrohet në kapacitete, dialogu në koordinim dhe koordinimi në veprim.

Mesazhet e përcjella nga Presidenti i Republikës, Ministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm e vendosën qartë Shqipërinë në këtë dimension: **një vend që beson te aleancat, investon në mbrojtje, forcon kapacitetet e veta dhe e sheh sigurinë si një përgjegjësi të përbashkët.**

Në një Evropë ku paqja nuk mund të merret më si e mirëqenë, bashkëpunimi ushtarak, besimi ndërmjet partnerëve dhe aftësia për të vepruar së bashku nuk janë vetëm objektiva politike. Ato janë garanci konkrete për stabilitetin, sigurinë dhe paqen e së ardhmes.



FARSH–FSK, bashkëpunim më i thelluar në edukimin dhe zhvillimin profesional

Gjeneralmajor Ferdinant Dimo zhvilloi një vizitë zyrtare në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së

Bashkëpunimi ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës vijon të konsolidohet dhe të zgjerohet në fusha me rëndësi të veçantë për zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe institucionale. Në këtë kuadër, Gjeneralmajor Ferdinant Dimo, Komandant i Akademisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, së bashku me delegacionin shoqërues, zhvilloi një vizitë zyrtare dyditore në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

Delegacioni i FARSH-së u prit nga gjeneral brigade Jeton Dreshaj, komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së, së bashku me drejtuesit dhe përfaqësuesit e kësaj komande. Vizita u zhvillua në frymën e marrëdhënieve të ngushta të bashkëpunimit ndërmjet dy forcave dhe krijoi një mundësi të rëndësishme për vlerësimin e bashkëpunimit të deritanishëm, si dhe për diskutimin e hapave të mëtejshëm për forcimin dhe zgjerimin e tij.

Edukimi dhe zhvillimi profesional, në fokus

Gjatë takimeve të zhvilluara në kuadër të vizitës, vëmendje e veçantë iu kushtua bashkëpunimit në fushën e edukimit, arsimimit, trajnimit dhe zhvillimit profesional të pjesëtarëve të FARSH-së dhe FSK-së. Përfaqësuesit e dy institucioneve shkëmbyen pikëpamje dhe përvoja mbi mënyrën e zhvillimit të proceseve të edukimit dhe formimit ushtarak, duke evidentuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional në përgatitjen e personelit ushtarak dhe në rritjen e kapaciteteve profesionale.

Në këtë drejtim, shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira përbën një vlerë të shtuar për të dyja institucionet, duke krijuar mundësi për identifikimin e fushave të reja, ku bashkëpunimi mund të zhvillohet më tej. Akademia e Forcave të Armatosura dhe Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së luajnë një rol të rëndësishëm në përgatitjen dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, nëpërmjet edukimit ushtarak, trajnimit dhe formimit profesional. Për këtë arsye, forcimi i bashkëpunimit ndërmjet tyre krijon një bazë të rëndësishme për shkëmbimin e njohurive, përvojave dhe praktikave institucionale.

Shkëmbim përvojash dhe mundësi të reja bashkëpunimi

Një nga elementet kryesore të vizitës ishte shkëmbimi i përvojave ndërmjet dy institucioneve. Përmes takimeve dhe diskutimeve profesionale, delegacionet shqyrtuan mundësitë për të identifikuar fusha të reja bashkëpunimi, me synim përmirësimin e mëtejshëm të proceseve të edukimit dhe trajnimit, si dhe forcimin e ndërveprimit ndërmjet strukturave përkatëse.

Bashkëpunimi në këto fusha merr rëndësi të veçantë në kushtet e zhvillimit të vazhdueshëm të profesionit ushtarak dhe të kërkesave gjithnjë e më të mëdha për personel të mirëtrajnuar, të arsimuar dhe të aftë për të vepruar në mjedise të ndryshme operacionale. Në këtë kuadër, kontaktet e drejtpërdrejta ndërmjet institucioneve të edukimit dhe trajnimit ushtarak shërbejnë jo vetëm për shkëmbimin e



informacionit dhe përvojave, por edhe për krijimin e mundësive konkrete për projekte dhe aktivitete të përbashkëta.

Një marrëdhënie që forcohet përmes bashkëpunimit

Marrëdhëniet ndërmjet FARSH-së dhe FSK-së janë karakterizuar nga një bashkëpunim i vazhdueshëm dhe një frymë e veçantë mirëkuptimi dhe mbështetjeje reciproke. Në këtë kuadër, vizita e delegacionit të Akademisë së Forcave të Armatosura në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes së FSK-së shërbeu për të riafirmuar vullnetin e përbashkët për thellimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërinstitucionale dhe zgjerimin e bashkëpunimit profesional.

Përtej dimensionit institucional, bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe trajnimit kontribuon edhe në forcimin e lidhjeve profesionale ndërmjet personelit të dy forcave. Shkëmbimi i eksperiencave, njohurive dhe praktikave krijon ura të reja komunikimi dhe bashkëpunimi, të cilat i shërbejnë zhvillimit të mëtejshëm të të dyja institucioneve.

Vizita u vlerësua gjithashtu si një mundësi për të parë nga afër përvojën dhe praktikat e KDS-së së FSK-së, si dhe për të diskutuar mbi sfidat dhe nevojat që lidhen me zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale.

Investimi te njerëzit, investim në kapacitetet e mbrojtjes

Edukimi dhe trajnimi mbeten ndër komponentët më të rëndësishëm të zhvillimit të kapaciteteve të një force të



armatosur moderne. Përgatitja profesionale e personelit, zhvillimi i lidershipit dhe përshtatja e programeve të edukimit me kërkesat e reja të sigurisë janë procese që kërkojnë bashkëpunim, shkëmbim përvoje dhe vlerësim të vazhdueshëm.

Në këtë perspektivë, bashkëpunimi FARSH–FSK përbën një investim të drejtpërdrejtë në njerëzit dhe në kapacitetet e të dyja forcave. Përmes nismave të tilla, krijohen mundësi për rritjen e njohurive profesionale, forcimin e lidershipit, përmirësimin e metodave të trajnimit dhe ndërtimin e një kulture të përbashkët profesionale.

Në përfundim të vizitës, u riafirmua përkushtimi i përbashkët i **Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës** për të vijuar dhe thelluar bashkëpunimin, veçanërisht në fushat e edukimit, arsimimit, trajnimit dhe zhvillimit profesional.

Vizita e gjeneralmajor Ferdinant Dimos dhe delegacionit të FARSH-së në KDS të FSK-së, shënoi kështu një tjetër hap në konsolidimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, duke vendosur në qendër të tij një objektiv të përbashkët: **zhvillimin e burimeve njerëzore, forcimin e kapaciteteve dhe përgatitjen e brezit të ardhshëm të profesionistëve të mbrojtjes.**



28–29 NËNTORI:
DY DITË, NJË KUJTESË, NJË SHQIPËRI



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Nga flamuri që u ngrit në Vlorë te flamuri që valëvitet sot mbi institucionet e shtetit, historia shqiptare ka ditë që nuk mjafton t'i kujtosh. Ato duhet t'i përjetosh, t'i kuptosh dhe t'ua përcjellësh brezave. 28 dhe 29 Nëntori janë pikërisht të tilla.

Data të caktuara nuk qëndrojnë në kalendar vetëm për përcaktim kohor, ato bëhen pjesë e ndërgjegjes së një kombi, sepse mbartin brenda tyre sakrifica, ëndrra, beteja, humbje, fitore dhe shpresën për të ardhmen. Për shqiptarët, 28 dhe 29 Nëntori janë dy nga ato ditë që e kanë kapërcyer kohën dhe janë kthyer në një kujtesë të gjallë kombëtare.

Dy data, dy ngjarje historike, dy momente të ndryshme të së njëjtës rrugë: **rrugës së Shqipërisë drejt lirisë, shtetësisë dhe dinjitetit kombëtar.**

28 Nëntori sjell përpara nesh Vlorën e vitit 1912, Ismail Qemalin dhe burrat që u mblodhën në atë ditë të madhe për të shpallur Pavarësinë e Shqipërisë. Në atë çast, pas shekujsh pushtimesh dhe përpjekjesh, një komb shpallte para botës se kishte të drejtë të ekzistonte si shtet i lirë.

Por 28 Nëntori nuk është vetëm dita e një akti politik. Është dita kur një aspiratë e gjatë kombëtare mori formën e një shteti. Është dita e flamurit, e atij simboli që shqiptarët e kanë mbajtur në duar në ditë të mira e të vështira, në luftë e në paqe, në vendlindje dhe larg saj. Flamuri nuk është vetëm një copë pëlhure. Në të janë mbledhur kujtesa e brezave, gjaku i atyre që ranë, shpresa e atyre që jetuan për një Shqipëri të lirë dhe përgjegjësia e atyre që jetojnë sot.

Në Vlorë, më 28 Nëntor 1912, Ismail Qemali ngriti flamurin dhe Shqipëria hyri në një epokë të re. Ishte një akt që do të mbetej në kujtesën kombëtare si një nga çastet themeluese të shtetit shqiptar. Por rruga drejt lirisë nuk u mbyll atë ditë. Ajo vazhdoi.

Vazhdoi përmes përpjekjeve për të mbrojtur shtetin e sapokrijuar, përmes luftërave, sakrificave dhe qëndresës së brezave që erdhën më pas. Dhe pikërisht këtu 29 Nëntori merr vendin e vet në kujtesën historike shqiptare.

29 NËNTORI, KUJTESA E ÇLIRIMIT

29 Nëntori lidhet me një tjetër moment vendimtar të historisë sonë: përfundimin e Luftës Nacionalçlirimtare dhe çlirimin e vendit nga pushtuesit nazifashistë në vitin 1944. Në atë kohë Shqipëria ishte një vend i varfër, i rrënuar nga lufta dhe i lodhur nga pushtimi. Pas viteve të rezistencës, sakrificave dhe humbjeve njerëzore, fundi i nëntorit 1944 shënoi për shqiptarët përfundimin e pushtimit.

Pas kësaj date do të niste një tjetër histori, me dritat dhe hijet e saj, me zhvillimet dhe kontradiktat e një epoke të gjatë. Por ajo që nuk mund të mohohet është se **kujtesa e atyre që luftuan dhe ranë për çlirimin e vendit mbetet pjesë e historisë së Shqipërisë.** Në këtë kuptim, 29 Nëntori është mbi të gjitha një ditë kujtese. Kujtesë për ata që nuk u kthyen më në shtëpi. Për të rinjtë që lanë familjet dhe morën rrugën e luftës. Për nënat që pritën bijtë dhe vajzat e tyre. Për familjet që mbajtën mbi supe dhimbjen e humbjes. Për një brez që e përjetoi luftën jo si një faqe libri, por si realitetin e përditshëm.

Historia nuk shkruhet vetëm me emra të mëdhenj. Ajo shkruhet edhe me jetën e njerëzve të zakonshëm që, në momente të jashtëzakonshme, bëhen pjesë e saj.

Prandaj, kur kujtojmë 29 Nëntorin, nuk duhet të kujtojmë vetëm një datë. Duhet të kujtojmë **çmimin e lirisë**. Sepse liria nuk ka ardhur kurrë falas.

MES DY DATAVE QË MBARTIN NJË SHEKULL HISTORI

28 dhe 29 Nëntori janë dy data të ndryshme, por në kujtesën kombëtare ato takohen në një pikë të përbashkët: **Shqipërinë.**

Njëra lidhet me shpalljen e shtetit të pavarur. Tjetra me çlirimin e vendit nga pushtimi. Mes tyre shtrihet një pjesë e madhe e historisë sonë: luftëra, sakrifica, përpjekje për shtetndërtim, dhimbje dhe shpresë. Dhe mbi të gjitha, njerëz që besuan se Shqipëria duhej të ishte e lirë. Njerëz që e paguan këtë bindje me jetën. Njerëz që punuan për ta ngritur vendin nga rrënojat. Njerëz që ruajtën gjuhën, traditat dhe identitetin. Dhe njerëz që, në çdo brez, kanë mbajtur mbi supe detyrën për ta mbrojtur atë që të parët e tyre fituan me aq shumë sakrifica.

Kjo është arsyeja pse festat kombëtare nuk duhet të jenë vetëm ceremoni.

Ato duhet të jenë momente reflektimi. *Çfarë kemi trashëguar? Çfarë kemi ndërtuar? Çfarë po u lëmë brezave që vijnë?*

FLAMURI QË NUK ËSHTË VETËM SIMBOL

Në çdo 28 Nëntor, flamuri kuqezi merr një kuptim të veçantë. Ai ngrihet në sheshe, në institucione, në oborre shkollash, në përfaqësitë diplomatike, në njësitë ushtarake. Valëvitet në qytete e fshatra dhe udhëton me shqiptarët kudo ku ata jetojnë. Por për një ushtarak, flamuri ka edhe një kuptim tjetër. Ai është betim. Është përgjegjësi. Është detyrë. Në çdo ceremoni ushtarake, kur flamuri kalon përpara rreshtimit dhe ushtari qëndron në gatishmëri, nuk është thjesht një ceremoni. Është një marrëdhënie e heshtur mes individit dhe atdheut.

Sepse uniforma nuk është vetëm një veshje. Ajo është një përgjegjësi e veshur. Pas saj qëndron detyrimi për të mbrojtur vendin, për të respektuar Kushtetutën, për të shërbyer me profesionalizëm dhe për të qenë i gatshëm kur vendi ka nevojë. Në këtë kuptim, 28 dhe 29 Nëntori kanë një mesazh të veçantë për Forcat e Armatosura.

Ato kujtojnë se **mbrojtja e atdheut nuk është një ide abstrakte. Është një detyrë konkrete që kërkon njerëz të përgatitur, institucione të forta dhe një shërbim të ndershëm.**

NGA KUJTESA TEK PËRGJEGJËSIA

Sot Shqipëria është anëtare e NATO-s. Forcat e saj të Armatosura janë pjesë e strukturave euroatlantike dhe kontribuojnë në misione ndërkombëtare për paqen dhe sigurinë. Ushtarët shqiptarë shërbejnë në mjedise ku flamuri kuqezi valëvitet krahas flamujve të aleatëve.

Kjo është një Shqipëri tjetër nga ajo e vitit 1912.

Është një Shqipëri që ka kaluar përmes një shekulli të trazuar, ka njohur luftëra, izolim, ndryshime të mëdha politike e shoqërore dhe një transformim të thellë institucional. Por një gjë mbetet e pandryshuar: **nevoja për të mbrojtur lirinë.**

Sot liria mbrohet edhe përmes aleancave, profesionalizmit, institucioneve demokratike, kapaciteteve moderne të mbrojtjes dhe aftësisë për të kontribuar në sigurinë kolektive. Kjo është edhe një nga arsyet pse historia dhe mbrojtja nuk mund të ndahen. Një ushtri që nuk njeh historinë e vendit të saj rrezikon të humbasë një pjesë të rëndësishme të kuptimit të misionit. Ndërsa një shoqëri që nuk e njeh çmimin e lirisë rrezikon ta marrë atë si të mirëqenë.

BREZAT NDRYSHOJNË, DETYRA MBETET

Në ditët e nëntorit, brezat takohen. Fëmijët shohin flamurin. Të rinjtë mësojnë historinë. Veteranët kujtojnë shokët e rënë. Ushtarakët nderojnë simbolin kombëtar. Familjet kujtojnë të afërmit që historia i mori shumë herët.

Dhe një komb i tërë kthen kokën pas për të kuptuar se nga vjen.

Kjo është forca e kujtesës. Ajo nuk na lejon të harrojmë. Por kujtesa ka vlerë vetëm kur kthehet në përgjegjësi. Të kujtosh të rënët do të thotë të respektosh jetën dhe paqen. Të kujtosh Pavarësinë do të thotë të mbrosh shtetin dhe institucionet. Të kujtosh Çlirimin do të thotë të kuptosh çmimin e lirisë. Të nderosh flamurin do të thotë të nderosh atë që ai përfaqëson. Dhe të shërbesh në uniformë do të thotë ta kthesh këtë përgjegjësi në mision të përditshëm.

SHQIPËRIA QË DUAM TË LËMË PAS

Ndoshta ky është mesazhi më i rëndësishëm që na sjellin 28 dhe 29 Nëntori. Historia nuk është vetëm ajo që ka ndodhur. Historia është edhe ajo që ne vendosim të bëjmë me trashëgiminë që kemi marrë.

Brezi i Ismail Qemalit na la një shtet. Brezi i luftës la pas një vend të çliruar. Brezat pas tyre ndërtuan dhe transformuan institucionet. Brezit të sotëm i takon ta forcojë Shqipërinë, ta mbrojë paqen dhe të ndërtojë një të ardhme më të sigurt për brezat që do të vijnë.

Në këtë udhëtim, Forcat e Armatosura kanë një rol të pazëvendësueshëm. Sepse një ushtri moderne nuk është vetëm forcë ushtarake. Është institucion i shtetit. Është pjesë e sigurisë kombëtare. Është përfaqësuese e Shqipërisë në aleancat ku vendi ka zgjedhur të jetë. Dhe, mbi të gjitha, është një bashkësi burrash e grash që kanë zgjedhur të shërbejnë.

Kjo zgjedhje meriton respekt. Sepse pas çdo uniforme qëndron një njeri. Një nënë, një baba, një bashkëshorte, një bashkëshort, një bir, një bijë. Një familje që pret. Një njeri që ka zgjedhur detyrën. Dhe pikërisht këtu, festa merr kuptimin e saj më njerëzor.

NËNTORI QË NA BASHKON

Në fund të nëntorit, Shqipëria nuk kujton vetëm të shkuarën. Ajo kujton veten. Kujton rrënjët. Kujton flamurin. Kujton ata që shpallën Pavarësinë. Kujton ata që luftuan dhe ranë. Kujton ata që ndërtuan shtetin. Kujton ata që sot shërbejnë për ta mbrojtur atë. Dy data, njëra pas tjetrës, na kujtojnë se liria është një trashëgimi që nuk duhet marrë kurrë si e mirëqenë.

Ajo fitohet. Mbrohet. Dhe u përcillet brezave.

Në Vlorë, më 28 Nëntor 1912, flamuri u ngrit si shenjë e një Shqipërie që lindte si shtet.

Në fundin e nëntorit 1944, Shqipëria doli nga lufta dhe pushtimi.

Sot, flamuri shqiptar valëvitet në një vend anëtar të NATO-s, ndërsa ushtarakët tanë shërbejnë krah aleatëve për paqen dhe sigurinë.

Kjo është rruga e gjatë që lidh tri kohë: **Shqipërinë që lindi, Shqipërinë që u çlirua dhe Shqipërinë që sot mbron lirinë e saj në një botë të re sigurie.**

Prandaj 28 dhe 29 Nëntori nuk janë vetëm dy ditë feste.

Janë dy ditë kujtese.

Dy ditë krenarie.

Dy ditë përgjegjësie.

Dhe mbi të gjitha, janë një ftesë për të mos harruar se pas çdo simboli qëndron një histori dhe pas çdo historie qëndron një detyrë.

Flamuri që u ngrit në Vlorë nuk është vetëm një kujtim i së shkuarës. Ai është përgjegjësi për të ardhmen.

Gëzuar 28 dhe 29 Nëntorin!

Gëzuar Shqipërinë!



"BIG BAND"

OSFA, MUZIKA SHQIPTARE NË ZEMËR TË BASHKËPUNIMIT ALEAT NË KOSOVË

Një tjetër përfaqësim i Shqipërisë përmes muzikës dhe kulturës në mjediset ku aleatët bashkëpunojnë për paqen dhe sigurinë

Në atmosferën festive të Nëntorit Kuq e Zi, muzika e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë u bë pjesë e kremtimeve për 114-vjetorin e Pavarësisë dhe Ditën e Flamurit në Kosovë. "Big Band" i Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura (OSFA) solli në Prishtinë një tjetër dëshmi të fuqisë së artit për të përcjellë identitetin, kulturën dhe mesazhin e miqësisë e të bashkëpunimit shqiptar.

Në kuadër të aktiviteteve të organizuara me rastin e 28 Nëntorit, ansambli muzikor i Forcave të Armatosura zhvilloi një performancë të veçantë në ambientet e **Camp Film City**, selia e KFOR-it në Kosovë. Në një mjedis ku përfaqësues të forcave të armatosura të vendeve aleate dhe partnere bashkëpunojnë çdo ditë për paqen dhe sigurinë, tingujt e muzikës shqiptare morën një kuptim të veçantë. Aktiviteti u zhvillua nën kujdesin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, në praninë e Shkëlqesisë së Tij, Ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. **Petrit Malaj**, si dhe të personaliteteve të shumta ushtarake e civile.

Performanca e "Big Band" nuk ishte vetëm një aktivitet artistik në kuadër të festimeve të Nëntorit. Ajo përfaqësoi Shqipërinë në një prej mjediseve më domethënëse të bashkëpunimit ndërkombëtar të sigurisë në Kosovë, duke e vendosur muzikën në shërbim të një mesazhi më të gjerë: atë të miqësisë, bashkëpunimit dhe vlerave që bashkojnë njerëzit dhe kombet.

Kur uniforma sjell edhe zërin e kulturës

Forcat e Armatosura nuk përfaqësohen vetëm nëpërmjet kapaciteteve ushtarake, stërvitjeve dhe angazhimeve operacionale. Në raste të tilla, ato shfaqin edhe një dimension tjetër të rëndësishëm të institucionit ushtarak **dimensionin kulturor**, përmes të cilit Shqipëria prezanton vlerat, traditat dhe identitetin e saj. Në këtë kuadër, "Big Band" ka një rol të veçantë. Muzika bëhet një formë komunikimi që kapërcen kufijtë e gjuhës dhe të uniformës, duke krijuar një hapësirë të përbashkët mes ushtarakëve, diplomatëve dhe qytetarëve. Performanca në Camp Film City e përcolli pikërisht këtë mesazh, duke e kthyer ceremoninë festive në një moment bashkimi dhe komunikimi kulturor. Prania e muzikantëve të Forcave të Armatosura shqiptare në Kosovë, në ditët kur shqiptarët festojnë Pavarësinë dhe Ditën e Flamurit, merr një simbolikë të veçantë. Është një prani që lidh historinë, identitetin kombëtar dhe të tashmen euroatlantike të Shqipërisë e Kosovës.

Nga Prishtina, një mesazh i përbashkët

Aktiviteti u zhvillua në një atmosferë ku simbolika e 28 Nëntorit u ndërthur me dimensionin ndërkombëtar të bashkëpunimit ushtarak. Në të njëjtën periudhë, Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Kosovë organizoi pritjen tradicionale me rastin e 114-vjetorit të Pavarësisë dhe Ditës së Flamurit, ku morën pjesë drejtues të lartë të institucioneve të Kosovës, diplomatë, përfaqësues të jetës publike dhe personalitete të shumta. Në këtë atmosferë festive, prania e Forcave të Armatosura shqiptare përmes "Big Band"-it të OSFA-së i dha kremtimeve një dimension të veçantë. Muzika e interpretuar nga ansambli ushtarak u bë një formë e natyrshme e përfaqësimit të Shqipërisë, duke e përcjellë festën kombëtare edhe në hapësirat ku bashkëpunimi ushtarak ndërkombëtar është pjesë e përditshmërisë.

Përtej skenës dhe performancës artistike, kjo ishte një tjetër mundësi për të treguar se **Forcat e Armatosura shqiptare janë pjesë e një realiteti të gjerë euroatlantik, ku siguria ndërtohet jo vetëm përmes kapaciteteve dhe angazhimeve ushtarake, por edhe përmes komunikimit, mirëkuptimit dhe vlerave që bashkojnë shoqëritë.**

Muzika që bashkon

Në Camp Film City, ku flamujt e vendeve aleate dhe partnere janë simbol i një angazhimi të përbashkët për paqen dhe sigurinë, tingujt e "Big Band" sollën një tjetër dimension të pranisë shqiptare. Ishte një përfaqësim që nuk kishte nevojë për shumë fjalë. Muzika foli vetë. Ajo solli atmosferën e festës shqiptare, ngjyrat e Nëntorit dhe emocionin e një date që për shqiptarët mbart peshë të veçantë historike. Nëpërmjet këtij aktiviteti, Orkestra Simfonike e Forcave të Armatosura dëshmoi edhe një herë se arti dhe kultura janë pjesë e rëndësishme e identitetit të një institucioni që përfaqëson vendin brenda dhe jashtë kufijve.



Nga Prishtina, në ditët e flamurit, "Big Band" i OSFA-së përcolli një mesazh të thjeshtë, por domethënës: **Shqipëria është e pranishme aty ku bashkëpunohet për paqen, sigurinë dhe miqësinë mes kombeve edhe me uniformën, edhe me zërin e kulturës së saj.**



Përgatitemi për luftë, që luftë të mos ketë

Nga “zbori” i diktaturës, te parandalimi demokratik



KOLONEL (R) HYSNI GJERGJI
Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes

Unë jam formuar në akademinë ushtarake në Shqipërinë luftës së ftohtë, por karrierën time si ushtarak e kam zhvilluar në akademitë e demokratizuara të vendit dhe ato perëndimore. Kjo përvojë e dyfishtë më ka mësuar të mos i ngatërroj dy gjëra që në situatën e sotme duken të afërta: gatishmërinë për mbrojtjen e atdheut nga njëra anë dhe kultivimin shtetëror të frikës së popullsisë nga lufta, nga ana tjetër.

Evropa aktualisht po armatoset me ritëm të shpejtë dhe zyrtarë të lartë politikë e ushtarakë perëndimorë i kërkojnë popullsisë civile pa përjashtim vigjilencë të shtuar dhe krijim rezervash ushqimi, ilaçesh, uji, energjie etj. Kjo situatë ka nuanca të cilat më kthejnë në mendje një fjalë nga e kaluara jonë, “zbori”, fjalë e cila lidhet me fjalën sllave “zbor”, që do të thotë mbledhje ose tubim. Në Shqipërinë e luftës së ftohtë, “zbori” emërtonte stërvitjen paraushtarake, e cila detyronte adoleshentët, gratë dhe gjithë qytetarët civilë, të stërviteshin për mbrojtjen territoriale. Qytetari duhej të dinte çfarë të bënte në rast sulmi, emergjence e deri në goditje bërthamore. “Zbori” i shërbente një ideologjie që e organizonte shoqërinë për një luftë të përhershme kundër të gjithëve dhe e paraqiste varfërinë si gjendje normale, të ardhur nga armiqtë e kudondodhur. Siç thoshte Naom Chomsky “Nëse kërkon kontroll të plotë të popullit, krijo armiq imagjinarë që duken më të rrezikshëm se sa ju, pastaj paraqite veten si shpëtimtar”. Kështu vepronte partia shtet dhe në diktaturë. Me këtë nuk dua të them se çdo përgatitje ushtarake civile në Shqipëri ishte e kotë.

Gjatë Luftës së Ftohtë përballë qëndronin Bashkimi Sovjetik dhe Perëndimi, me dy blloqe politike dhe një garë armësh bërthamore që mund ta shkatërronte njerëzimin. Sot Rusia është pasardhësja politike e një pjese të fuqisë sovjetike, megjithëse jo i gjithë Bashkimi Sovjetik, por si kërcënim për perëndimin është e njëjta gjë. Rusia po përballet me sanksione, po konsumon njerëz dhe pajisje në luftën kundër Ukrainës dhe po shpenzon pa limit për armatosjen e saj. SIPRI (Stokholm International Peace Research Institute) vlerëson se shpenzimet ushtarake ruse për vitin 2026 u planifikuan në 14,9 trilionë rubla, rreth 6,3 për qind të PBB-së, ndërsa presionet inflacioniste, kostot e luftës dhe mungesa e burimeve e detyrojnë Kremlinin të bëjë zgjedhje të vështira. Rusia ka kapacitet për të vazhduar luftë e për të krijuar probleme serioze, por kapaciteti i saj nuk është i pakufizuar dhe as i barabartë me aftësinë për të mposhtur të gjithë Evropën. Por do të ishte gabim të nxirrnim përfundimin se Rusia nuk përbën kërcënim ushtarak. IISS (International Insttitute for Strategic Studies) vlerëson se Rusia ka arritur të mbajë ritëm rekrutimi të mjaftueshëm për të vazhduar luftën, megjithëse rekrutimi ra nga fundi i vitit 2025.

Perëndimi, përballë Rusisë nuk është një organizëm i vetëm me komandim-kontroll C2 dhe nuk ka industri ushtarake të integruar dhe centralizuar. NATO, e cila përfaqëson perëndimin përballë Rusisë, përfshin rreth 970 milionë banorë dhe PBB-ja e përbashkët e aleatëve vlerësohej rreth 57 trilionë dollarë në vitin 2025. Përballë saj, Rusia kishte 143,5 milionë banorë dhe PBB nominale prej 2,56 trilionë dollarësh në 2025. Territori i 32 aleatëve të NATO-s është rreth 25 milionë kilometra katrorë. Rusia shtrihet në rreth 17,1 milionë kilometra katrorë. NATO raportonte rreth 3,4 milionë personel ushtarak në vitin 2024, ndërsa dekreti rus i shtatorit të 2026 caktoi 1,55 milionë si numër të autorizuar të personelit aktiv. SIPRI vlerësoi se shpenzimet ushtarake në 2025 në rreth 1,58 trilionë dollarë për NATO-n dhe 190 miliardë dollarë për Rusinë.

Sipas raportit vjetor të NATO-s, aleatët evropianë dhe Kanadaja shpenzuan rreth 574 miliardë dollarë në mbrojtje gjatë vitit 2025, që është 20 për qind më shumë në terma realë se në 2024. Të gjithë aleatët përfshirë Shqipërinë raportuan se kanë arritur objektivin e vjetër prej 2 për qind të PBB-së. Por shuma e buxheteve të 32 anëtarëve nuk është e njëjtë me një ushtri të vetme, të gatshme e të integruar. Pajisjet, municionet, logjistika, zinxhirët e furnizimit dhe vendimmarrja mbeten akoma të ndara mes shteteve.



Shpenzimi duhet matur me kapacitetin real që krijon, jo me frikën që e justifikon. Bazuar në krahasimet analitike të mësipërme, unë jam më i bindur për vazhdimësinë e luftës hibride të Rusisë, e cila nuk do të thotë që tanket do të kalojnë kufirin. Synimi rus do të jetë të dëmtojnë besimin, të ngadalësojnë vendimmarrjen, të përçajnë shoqëritë perëndimore dhe të bindin qytetarët e saj se institucionet demokratike nuk i mbrojnë dot. Kjo formë presioni është intensifikuar dhe është bërë më e shpejtë e më e vështirë për t’u identifikuar. Zyrtarët gjermanë për shembull vlerësojnë se Rusia mund të krijojë aftësi për një sulm të gjerë ndaj NATO-s rreth vitit 2029. Kërcënimi bërthamor megjithëse në Pekin, më 19 nëntor 2026, ishte një nga pikat që Rusia, Kina dhe SHBA-ja ranë dakord se është një luftë që “nuk ka fitues”, NATO paralajmëron qytetarët e saj për përgatitje për ditën më të keqe, duke iu kërkuar atyre të kenë rezerva ushqimore, energji, ujë dhe komunikim për disa ditë. Ngjashmërisht kështu stërviteshin edhe prindërit tanë gjatë “zborit”, kundër një armiku që nuk identifikohej, duke marrë mësime edhe se si t’i bënim ballë rrezikut bërthamor, me rrezatimin ndriçues, valën goditëse dhe shiun radioaktiv.

Një operacion hibrid synon të mbajë shoqërinë në alarm, kështu që përgjigjja jonë nuk mund të jetë as mohimi i rrezikut, as paniku. Pikërisht këtu bashkohet logjika e “zborit” të asaj kohe, me kërcënimin “hibrid” aktual. Institucionet demokratike e kanë detyrim që t’i shpjegojnë publikut çfarë rreziku ekziston, çfarë nuk dihet, çfarë po bëhet dhe çfarë nuk po bëhet si duhet. Nga alarmi te mbrojtja civile duhet bërë një dallim praktik. Qytetarët nuk kanë nevojë të jetojnë si ushtarë për të qenë të përgatitur, pasi do të ishte një “zbor” i ngjashëm dhe i padeklaruar. Mediat e shkollat duhet të mësojnë se si verifikohet një lajm para se ai të shpërndahet. Këto aftësi kanë vlerë edhe në kushtet e paqes. Ato rrisin qëndrueshmërinë e shoqërisë, pa e kthyer çdo qytetar në objekt mobilizimi ideologjik.

Epërsia e përgjithshme e NATO-s nuk e zhduk rrezikun lokal, bërthamor apo konvencional të mundshëm. Qytetari perëndimor duhet të dijë ku të gjejë njoftimet zyrtare dhe çfarë veprimi të marrë. Nuk duhet të informohet me mesazhe të përgjithshme se “kërcënimi është kudo”. Përndryshe, stërvitja bëhet përsëritje e “zborit” të vjetër me propagandë, fotografi dhe me pak rritje kapacitetesh të mbrojtjes civile të popullsisë. Debati për armatosjen kërkon seriozitet dhe maturi, pasi miliardat nuk janë vetë siguria. Duhet të bindemi që paratë krijojnë municion, mbrojtje ajrore, logjistikë, komunikim të sigurt, rezerva të mirëmbajtura dhe industri që mund të prodhojë edhe në kohë krize. Vetëm transparenca e ul dyshimin dhe e ndihmon publikun të dallojë investimin mbrojtës, nga gara e armatimeve e kohës së “zborit”.

Për Shqipërinë dhe vendet e rajonit, nuk është e nevojshme të kopjojë çdo model të shteteve të fuqishme. Si aleatë të NATO-s, ne duhet të forcojmë mbrojtjen e infrastrukturës kritike, sigurinë kibernetike, reagimin ndaj fatkeqësive, shkëmbimin e informacionit me aleatët dhe komunikimin publik. Këto janë kontribute të prekshme që nuk kërkojnë alarm të përhershëm, por institucione që punojnë bashkë dhe qytetarë që besojnë se po u thuhet e vërteta. Një shoqëri që e ruan qetësinë dhe vazhdimësinë e shërbimeve është më e vështirë të tronditet nga subversioni apo dezinformimi.

Dilema e sigurisë është realiteti i sotëm, pasi Rusia e paraqet armatosjen perëndimore si kërcënim për të. Perëndimi nga ana tjetër e justifikon armatosjen si mjet për të penguar agresionin rus. Nëse nuk përgatitemi, mund të kapemi në befasi, por edhe nëse alarmohemi pa kufi, pa transparencë e pa komunikim, kjo mund ta ushqejë garën e armatimit dhe mosbesimin e publikut, të trashëguar nga lufta e ftohtë. Përgjigjja nuk është të zgjedhim mes “shpërfilljes së rrezikut” dhe “militarizimit të shoqërisë”, por të ndërtojmë mbrojtje të besueshme civile, të mbështetur me ligj dhe të shpjeguar me transparencë për taksapaguesit. “Zbori” i dikurshëm u bë qesharak, atëherë kur u përsërit pa kuptim, pa arsye, pa shpjegim dhe pa rezultat.

Në vazhdën e metaforës pyetja sot është: A po na bën “zbor” Rusia? Metaforikisht po, sepse kërcënimi hibrid “kudo”, kërkon të “pushtojë” së pari mendjet, të ndikojë në besimin dhe në mënyrën se si ne i marrim vendimet.

Analiza e kërcënimit që po përjetojmë nga viti 2022 na shtyn të mbështesim çdo shpenzim pa pyetur për rezultat dhe të pranojmë kufizime në jetën e përditshme, të bindur që po bëjmë gjënë e duhur. Qytetari evropian, ku edhe ne bëjmë pjesë, është sot më i mobilizuar emocionalisht, më i aftësuar, më i informuar dhe rrjedhimisht më i sigurt. Ne duhet të përgatitemi për luftë që luftë të mos ketë, jo të ushqyer me frikë dhe panik por propocionalisht, me maturi dhe besim te institucionet. Ky është dallimi mes “zborit” që prodhoi mosbesim për një luftë “imagjinare” dhe një përgatitjeje që zë fill tek rreziku, i cili kërcënon paqen dhe jetën e qytetarëve tanë.

Mësimi i nxjerrë, nuk është të heqim dorë nga stërvitja e popullsisë civile, por ajo duhet të jetë konkrete, e besueshme dhe proporcionale. Demokracia nuk e trajnon shoqërinë të jetojë në panik, por e bën atë të aftë të ruajë gjykimin edhe kur jeton nën presion. Por kujdes, nëse kthejmë çdo paralajmërim në alarm të përhershëm, atëherë po bëjmë saktësisht atë çfarë Rusia kërkon, po përhapim dezinformacionin, përçarjen, pasigurinë dhe frikën.

NJË BREZ QË U FORMUA PËR ATDHEUN, SOT I KTHEHET KUJTESËS

Promovohet monografia "Skënderbegas, pasaportë e vlerave atdhetare", një dëshmi për brezin 1983–1987 dhe një pasuri për kujtesën e Ushtrisë Shqiptare

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve



Një brez mund të largohet nga bankat e shkollës, nga uniforma dhe nga vitet e shërbimit, por nuk duhet të largohet nga kujtesa. Pikërisht këtë kujtesë sjell në faqet e saj monografia "Skënderbegas, pasaportë e vlerave atdhetare" (Brezi 1983–1987), e poetit, studiuesit dhe historianit Agim Lika, një dëshmi për njerëzit, formimin, vlerat dhe kontributin e një brezi të rritur me idealin e shërbimit ndaj Atdheut.

Ajo nuk është thjesht një monografi për një brez nxënësish të Shkollës së Mesme Ushtarake "Skënderbej". Është një përpjekje për të ruajtur në faqet e një libri njerëz, histori, kujtime, formim, sakrifica dhe kontribute të atyre që u përgatitën në një institucion të rëndësishëm të edukimit dhe formimit ushtarak shqiptar dhe që më pas morën rrugët e shërbimit në Forcat e Armatosura dhe në fusha të tjera të jetës së vendit. Pikërisht për këtë arsye, promovimi i saj nuk ishte vetëm një veprimtari kulturore. Ishte një takim me kujtesën.

Një takim me një brez. Një takim me një pjesë të historisë së Ushtrisë Shqiptare.

Në "Aleks Buda", një histori që rikthehet në vëmendje

Në sallën "Aleks Buda" të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në Tiranë, më **21 nëntor 2026**, u zhvillua veprimtaria promovuese e librit monografik **"Skënderbegas, pasaportë e vlerave atdhetare" (Brezi 1983–1987)**, me autor **Agim Likën**.

Veprimtaria u organizua nga **Shoqata Kombëtare Skënderbegasi "Nderi i Kombit"**, në bashkëpunim me **Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë**, dhe mblodhi në një sallë ish-skënderbegas nga treva të ndryshme të vendit, personalitete të fushave të ndryshme, drejtues shoqatash, poetë, shkrimtarë, studiues dhe miq të autorit.

Në pamje të parë, ishte një promovim libri. Në thelb, ishte shumë më tepër. Ishte një rikthim te vitet e rinisë, te bankat e shkollës, te uniforma, te disiplina, te miqësitë e krijuara në moshë të hershme dhe te rrugët që morën më pas djemtë e vajzat e një brezi të formuar në një institucion me një traditë të veçantë në historinë e arsimit ushtarak shqiptar. Kujtimet u ndërthurën me vlerësimet. Emocioni u bashkua me analizën. Dhe historia personale e shumë prej të pranishmëve u bë pjesë e një historie më të madhe: asaj të brezave që shërbyen në Ushtrinë Shqiptare.

Një libër që nuk lejon kujtesën të humbasë

Një nga vlerat më të rëndësishme të monografisë së Agim Likës është pikërisht përpjekja për të sistemuar dhe ruajtur një kujtesë që, nëse nuk dokumentohet, rrezikon të mbetet vetëm në kujtimet personale të protagonistëve.

Një brez ushtarak nuk përbëhet vetëm nga datat e diplomimit, gradat apo detyrat e mbajtura gjatë karrierës. Pas secilit emër qëndron një histori njerëzore: familja, shkolla, shokët, mësuesit, pedagogët, repartet, stërvitjet, vështirësitë, sukseset, dështimet, misionet dhe përvojat që kanë ndërtuar një jetë të tërë.

Kjo është arsyeja pse një monografi e tillë ka vlerë edhe përtej brezit që ajo trajton. Ajo i shërben kujtesës së Ushtrisë Shqiptare. Sepse Ushtria nuk është vetëm historia e institucioneve dhe strukturave të saj. Është historia e njerëzve që e kanë mbajtur atë në këmbë. Është historia e oficerëve, nënoficerëve, ushtarëve, pedagogëve, komandantëve dhe specialistëve. Është historia e brezave. Dhe sa herë që njëri prej këtyre brezave dokumentohet, një pjesë e historisë së Forcave të Armatosura ruhet për brezat që vijnë.

"Skënderbej" – më shumë se një shkollë

Në diskutimet e mbajtura gjatë veprimtarisë, një ide u përsërit në forma të ndryshme: **Shkolla "Skënderbej" nuk ishte thjesht një institucion arsimor.**

Ajo ishte një mjedis formimi. Aty nuk mësoheshin vetëm lëndët. Mësohej disiplina, përgjegjësia, bashkëpunimi dhe respekti për shokun. Ndjenja e detyrës, dashuria për vendin dhe, mbi të gjitha, përgatitej një brez që do të merrte përsipër përgjegjësi në shërbim të Atdheut. Në këtë kuptim, historia e brezit 1983–1987 është një fragment i rëndësishëm i historisë së kësaj tradite. Libri e sjell këtë brez jo vetëm përmes kujtimeve, por edhe përmes përvojave dhe rrugëve që ndoqën pjesëtarët e tij pas përfundimit të shkollës. Disa vazhduan karrierën ushtarake. Disa u bënë pedagogë, disa studiues, të tjerë shkrimtarë, drejtues, specialistë apo profesionistë në fusha të ndryshme. Por ajo që i bashkoi ishte një formim i përbashkët.

Një fillim i përbashkët. Një kujtesë që vazhdon të jetojë.

Fjalët e vlerësimit për një brez

Në këtë atmosferë u përcollën edhe vlerësimet e pjesëmarrësve.

Agim Bajrami përshëndeti në emër të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve dhe Shtëpisë së Shkrimtarëve dhe Artistëve Durrës.

Prof. Dr. Kristaq Xharo u ndal te tradita, formimi dhe kontributi i brezave të Skënderbegasve, duke vënë në dukje rëndësinë e kësaj trashëgimie në formimin e kuadrove dhe në shërbim të vendit.

Prof. Dr. Bajram Hysa solli vlerësime mbi formimin intelektual dhe vlerat e brezit 1983–1987.

Një moment i veçantë ishte interpretimi poetik i **Glea Muratit**, studente, e cila solli për të pranishmit një poezi nga libri.

Më pas, **Ilirian Zeqo** foli për kontributin e brezit të Skënderbegasve në shërbim të Atdheut dhe shoqërisë.

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj, studiues dhe autor i njohur i historisë ushtarake, solli kujtime dhe reflektime mbi traditën dhe vlerat e Skënderbegasve.

Në emër të Shoqatës "Ishmi" përshëndeti **Isuf Shehi**.

Ndërsa **Behar Gjoni**, nënkryetar i Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Pension, Dega Durrës, përcolli përshëndetjen dhe vlerësimin për autorin dhe veprën e tij.

Të gjitha këto ndërhyrje, të ndryshme në formë dhe në këndvështrim, u bashkuan në një ide: **vlera e një brezi nuk**



matet vetëm me atë që ka qenë, por edhe me atë që ka lënë pas.

Agim Lika, autori që e ktheu kujtesën në libër

Në qendër të kësaj veprimtarie ishte autori. **Nënkolonel (R) Agim Lika**, nga Ishmi i Durrësit, ish-skënderbegas i viteve 1983–1987, i diplomuar në Akademinë Ushtarake dhe me një karrierë si oficer i lartë në Forcat e Armatosura, ka qenë pjesëmarrës edhe në misione jashtë vendit në kuadër të NATO-s. Por karriera ushtarake nuk është e vetmja fushë ku ai ka dhënë kontribut. Agim Lika është gjithashtu shkrimtar dhe poet, autor i **13 librave** me tematikë historike, monografike dhe folklorike.

Kjo përvojë e dyfishtë, ajo e ushtarakut dhe ajo e studiuesit e shkrimtarit, duket se ka ndikuar edhe në mënyrën se si është konceptuar monografia.

Ai nuk e sheh historinë vetëm si një varg datash. E sheh si kujtesë njerëzore. Dhe pikërisht këtë përpiqet të bëjë me "Skënderbegas, pasaportë e vlerave atdhetare". Të mbledhë dëshmi. Të ruajë emra. Të rikthejë kujtime. Të dokumentojë një brez. Dhe, mbi të gjitha, t'u japë atyre një vend në kujtesën e shkruar.



Fjala e autorit, mirënjohje dhe përgjegjësi

Një nga momentet më të ndjera të veprimtarisë ishte fjala e autorit, Agim Lika. Ai ndau me të pranishmit rrugëtimin drejt realizimit të kësaj monografie, vështirësitë e punës, bashkëpunimin me njerëzit që kanë kontribuar në të dhe mirënjohjen për të gjithë ata që ndihmuan që kujtesa e këtij brezi të merrte formën e një libri. Por fjala e tij nuk ishte vetëm një retrospektivë. Ajo ishte edhe një mesazh për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Sepse historia, kur shkruhet, nuk i përket vetëm atyre që kanë jetuar atë kohë.

Ajo u përket edhe atyre që do të vijnë. Dhe një brez që nuk e dokumenton historinë e vet, rrezikon që një pjesë e së vërtetës së tij të humbasë bashkë me njerëzit që e kanë përjetuar.

Nga kujtesa e një brezi te kujtesa e Ushtrisë

Pikërisht këtu qëndron edhe vlera më e madhe e kësaj monografie. Ajo është një vepër që i shtohet fondit të kujtesës së Ushtrisë Shqiptare. Në dekadat e fundit, shumë njerëz që kanë shërbyer në Forcat e Armatosura janë larguar nga jeta. Me ta rrezikojnë të humbin edhe kujtime, dokumente, dëshmi dhe përvoja që nuk janë regjistruar në kohë.

Prandaj çdo libër që dokumenton jetën e një brezi ushtarak është një kontribut për historinë.

Nuk ka rëndësi nëse bëhet fjalë për një komandant të lartë apo për një grup djemsh e vajzash që dikur u ulën së bashku në bankat e shkollës. Sepse historia e Ushtrisë është mozaik. Dhe çdo brez është një gur i atij mozaiku.

Brezi 1983–1987 është sot pjesë e këtij mozaiku të dokumentuar. Nëpërmjet tyre, lexuesi mund të shohë një periudhë, një mënyrë formimi, një kulturë institucionale dhe një brez njerëzish që u përgatitën për të shërbyer.

Më shumë se një promovim

Në fund të veprimtarisë, fotografia e përbashkët mblodhi bashkë autorin, ish-skënderbegasit, studiuesit, miqtë dhe të ftuarit. Më pas, kokteji dhe bashkëbisedimet vijuan në një atmosferë miqësore, ku kujtimet e bukura u ndërthurën me bisedat për të tashmen dhe të ardhmen. Por ajo që mbeti nga kjo ditë nuk ishte vetëm fotografia.

Mbeti libri.

Dhe bashkë me të, një dëshmi.

Një dëshmi se një brez nuk pranon të zhduket në harresën e kohës.

Se miqësitë e krijuara në bankat e "Skënderbeut" vazhdojnë të jetojnë. Se tradita ushtarake nuk ruhet vetëm në muze, arkiva dhe dokumente zyrtare, por edhe në kujtesën e njerëzve që e kanë jetuar atë. Dhe se historia e Ushtrisë Shqiptare ka nevojë për këto zëra.

Një "pasaportë" që nuk skadon

Titulli i librit: **"Skënderbegas, pasaportë e vlerave atdhetare"**, merr në këtë kontekst një kuptim të veçantë.

Pasaporta zakonisht është dokumenti që dëshmon identitetin e një njeriu. Kjo monografi është një lloj pasaporte kolektive. Ajo dëshmon identitetin, formimin dhe rrugëtimin e një brezi. Por, mbi të gjitha, dëshmon se vlerat nuk kanë datë skadence. Disiplina, përgjegjësia, dituria, shoqëria, sakrifica dhe dashuria për Atdheun nuk janë vlera të një kohe të kaluar. Ato janë vlera që çdo brez ka nevojë t'i rizbulojë. Pikërisht për këtë arsye, monografia e Agim Likës nuk duhet parë vetëm si libri i një brezi. Është një pjesë e kujtesës sonë të përbashkët. Është një kontribut për historinë e arsimit ushtarak shqiptar. Është një homazh për njerëzit që u formuan në "Skënderbej". Dhe është një kujtesë se pas çdo historie të madhe institucionale qëndrojnë gjithmonë njerëzit. Njerëzit që mësojnë. Njerëzit që shërbejnë. Njerëzit që sakrifikojnë. Dhe njerëzit që, shumë vite më vonë, kthehen pas për të treguar historinë e tyre.

"Skënderbegas, pasaportë e vlerave atdhetare" është pikërisht ky kthim. Një kthim te kujtesa, për ta ruajtur atë dhe për t'ua dorëzuar brezave që vijnë.

Sepse një Ushtri që respekton të ardhmen, duhet të dijë të nderojë edhe kujtesën e njerëzve që e ndërtuan atë.

15 VJEÇ, POR ME GUXIMIN E NJË BURRI: HISTORIA E FAIK VELIKAJT



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI



Në historinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare shqiptare, krahas emrave të luftëtarëve që morën armët, qëndrojnë edhe historitë e shumë njerëzve të zakonshëm që, në forma të ndryshme, mbështetën rezistencën kundër pushtuesve. Mes tyre është edhe Faik Qamil Velikaj, djaloshi nga Krahësi i Sipërm, jeta e të cilit u ndërpre tragjikisht, më 27 nëntor 1943, kur ishte vetëm 15 vjeç.

Historia e Faikut lidhet ngushtë me traditat atdhetare të familjes së tij. Ai lindi më 5 mars 1928, në një familje të njohur për kontributin e saj në lëvizjen kombëtare. I ati, Qamil Selim Zyka Velikaj, kishte marrë pjesë në kryengritjet e viteve 1911–1912 dhe në Luftën e Vlorës, më 1920. Gjatë viteve të pushtimit fashist, shtëpia e familjes Velikaj u kthye në një nga vatrat mbështetëse të rezistencës antifashiste në krahinën e Krahësit. Aty strehoheshin luftëtarë dhe siguroheshin ushqime, veshmbathje e ndihma të tjera për formacionet partizane.

Në këtë mjedis familjar u formua edhe ndërgjegjja atdhetare e Faikut. Edhe pse ende fëmijë, ai nuk qëndroi i shkëputur nga ngjarjet që po përjetonte vendi. Sipas dëshmive të përcjella nga bashkëkohës dhe burimeve historike, ai shërbeu si korrier, përcolli njoftime dhe ndihmoi në transportimin e materialeve për luftëtarët e rezistencës. Ishte një detyrë e rrezikshme për moshën e tij, por që dëshmon përfshirjen e tij në mbështetje të luftës antifashiste.

Edhe familja e tij ishte e lidhur drejtpërdrejt me formacionet partizane. Vëllai i Faikut, Xhelo Velikaj, ishte rreshtuar në Brigadën XIX Sulmuese. Kjo lidhje familjare me lëvizjen partizane do të kishte pasoja tragjike për familjen.

27 nëntor 1943, dita tragjike

Më 27 nëntor 1943, gjatë një ekspedite të forcave gjermane dhe formacioneve bashkëpunëtore në zonën e Krahësit, disa banorë u morën me forcë dhe u dërguan në fshatin Zhulaj. Midis tyre ishte edhe 15-vjeçari Faik Velikaj.

Sipas të dhënave të përcjella në monografinë e Veli Llakajt, *"Krahësi i Sipërm në vite"*, si dhe dëshmive të bashkëkohësve, Faiku u vra pasi nuk pranoi të qëllonte kundër partizanëve. Plumbat i ndërprenë jetën një djaloshi që ende nuk e kishte nisur plotësisht rrugën e rinisë.

Vrasja e tij nuk ishte vetëm një tragjedi familjare. Ajo ishte një nga ato ngjarje të shumta që dëshmojnë se lufta preku edhe moshat më të reja dhe se mbështetja ndaj rezistencës antifashiste kishte forma të ndryshme, nga lufta e armatosur deri te shërbimet e korrierit, strehimi dhe furnizimi i luftëtarëve.

Por dhimbja e familjes Velikaj nuk përfundoi me humbjen e Faikut. Pas luftës, familja u përball me pasoja të tjera të rënda politike dhe ekonomike, veçanërisht pas dënimit të Xhelos. Sipas dëshmive të përcjella ndër vite, edhe trajtimi

> Më 27 nëntor 1943, gjatë një ekspedite të forcave gjermane dhe formacioneve bashkëpunëtore në zonën e Krahësit, disa banorë u morën me forcë dhe u dërguan në fshatin Zhulaj. Midis tyre ishte edhe 15-vjeçari Faik Velikaj.

financiar që nëna, Zene, kishte përfituar në kujtim të djalit të vrarë u ndërpre. Kështu, mbi dhimbjen e humbjes u shtuan edhe pasojat e zhvillimeve politike të pasluftës.

Një histori që kërkon vlerësim institucional

Pas më shumë se tetë dekadash, emri i Faik Qamil Velikajt mbetet i lidhur me sakrificën e një brezi të ri që u përfshi në ngjarjet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Por rrethanat e jetës dhe veçanërisht të vrasjes së tij ngrenë edhe çështjen e vlerësimit të statusit të tij në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Faik Qamil Velikaj ishte vetëm 15 vjeç. Ai nuk arriti të shihte çlirimin e vendit, të jetonte rininë apo të ndërtonte të ardhmen e tij. Por historia e tij mbetet pjesë e kujtesës së Krahësit dhe e një periudhe të rëndë të historisë shqiptare.

Një djalosh që nuk pati mundësi të jetonte të ardhmen, por që sakrifikoi jetën në një kohë kur liria ishte ende një ëndërr. Kujtimi i tij nuk kërkon mëshirë; kërkon të vërtetën, drejtësinë historike dhe vlerësimin që i takon.

Faik Qamil Velikaj, bir i Krahësit, një emër që meriton të dalë nga hija e harresës.

Dëshmorët e Qarkut Fier dhe familjet me shumë dëshmorë



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj
Mjeshtër i Madh



Gjurmë të pashlyeshme në historinë e qëndresës dhe të lirisë

Historia e Qarkut Fier është e lidhur ngushtë me traditat atdhetare, kryengritjet popullore dhe luftërat për liri e pavarësi. Në këtë trevë, ku Myzeqeja shtrihet si një hapësirë e gjerë e punës, e sakrificës dhe e traditave patriotike, breza të tërë shqiptarësh janë ngritur kundër pushtuesve, duke dëshmuar se dashuria për Atdheun ka qenë një nga vlerat më të qëndrueshme të kësaj popullsie. Sipas të dhënave të deritanishme, dëshmorët e Qarkut Fier ndahen në disa periudha historike: rreth **60** dëshmorë të Rilindjes Kombëtare dhe të Pavarësisë, deri në vitin 1939; rreth **950** dëshmorë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe rreth **130** dëshmorë të periudhës pas Çlirimit deri në ditët tona. Rreth **700** prej tyre prehen në varrezat e dëshmorëve të Fierit, Lushnjës dhe Ballshit.

Tradita e hershme e qëndresës atdhetare

Që në shekullin XIX, Myzeqeja u bë një nga vatrat e rëndësishme të qëndresës popullore. Në këtë traditë qëndrese zë një vend të veçantë edhe kryetrimi Rrapo Hekali, emri i të cilit u bë simbol i trimërisë popullore. Këngа e njohur: "O more Rrapo Hekali, kur thërret sa gjëmon mali", ruan jehonën e një kohe kur fjala dhe pushka e burrave të kësaj treve u bashkuan në luftën kundër sundimit osman. Rrapo Hekali, i cili u vra në vitin 1847, përfaqëson një nga figurat e shquara të qëndresës dhe të flijimit për liri. Tradita luftarake e myzeqarëve vazhdoi edhe në vitet që pasuan. Pas shpalljes së Pavarësisë, shumë luftëtarë nga Myzeqeja dhe Mallakastra iu përgjigjën thirrjes për mbrojtjen e trojeve shqiptare, duke marrë pjesë në luftimet për Janinën. Sipas të dhënave arkivore, mbi 22 luftëtarë nga këto treva ranë në fushën e betejës, ndër ta Hajredin Fratari dhe Ismail Klosi. Në Luftën e Vlorës të vitit 1920, mbi 13 luftëtarë nga çetat e Lushnjës, Fierit dhe Mallakastrës dhanë jetën për çlirimin e Vlorës. Kryengritja e Fierit e vitit 1935 dhe përsëri dëshmorë, duke dëshmuar se fryma e kundërshtimit ndaj padrejtësisë e shtypjes nuk ishte shuar.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe sakrifica e familjeve myzeqare

Në historinë e kësaj treve Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare përfshiu qindra njerëz, të cilët, pavarësisht moshës, gjendjes ekonomike dhe prejardhjes shoqërore, u bashkuan në përpjekjen për çlirimin e vendit. Në këtë luftë nuk u përfshinë vetëm partizanët që mbanin pushkën në krah. Një rol të rëndësishëm luajtën edhe mjaft familje, gra, të rinj, fshatarë dhe patriotë, të cilët u vunë në shërbim të qëndresës, duke strehuar luftëtarë, siguruar ushqime, përcjellë informacione dhe mbështetur bazat e lëvizjes antifashiste. Shumë familje myzeqare paguan një çmim të rëndë, duke dhënë nga dy bij e bija, vëllezër e motra, baballarë e nëna. Lufta nuk ishte vetëm një zgjedhje individuale, por një angazhim i përbashkët familjar, ku sakrifica u bë pjesë e historisë së brezave.

Sakrificat vazhduan edhe pas Çlirimit

Për shumë luftëtarë dhe familje, vuajtjet nuk përfunduan me mbarimin e luftës. Vitet e para pas Çlirimit sollën përsëri përplasje, dhunë dhe humbje jete. Forcat e Divizionit të Mbrojtjes së Popullit dhe popullsia civile u përballën me ngjarje të tjera të rënda, në një periudhë kur vendi po kalonte një fazë të vështirë të konsolidimit të rendit të ri politik. Edhe në periudhën e demokracisë, vendi u përball me ngjarje të rënda kriminale, me sfida për vendosjen e rendit, luftën kundër trafiqeve, drogës dhe kriminalitetit. Historia e njerëzve që humbën jetën në shërbim të vendit nuk kufizohet vetëm në LANÇ, por përfshin dhe periudha të tjera të historisë.

Familja Kurti – një shtëpi në zemër të qëndresës në Ngurrëz të Madhe

Një vend të veçantë në historinë e sakrificës familjare zë familja Kurti e Ngurrëzës së Madhe në Myzeqe. E ngritur mbi tradita të hershme familjare dhe luftarake, kjo familje u përfshi aktivisht në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Shtëpia e saj nuk ishte vetëm një vendbanim, por u kthye në një nga bazat e mbështetjes së luftës në zonë, duke vënë në dispozicion njerëzit, pasurinë dhe mundësitë ekonomike të familjes. Mbi katërmbëdhjetë pjesëtarë të familjes u radhitën në formacionet partizane dhe në veprimtarinë antifashiste. Njëmbëdhjetë prej tyre humbën jetën në rrethana lufte ose në përballjet që pasuan. Sipas dëshmive të përcjella për familjen, pjesëtarët e saj nuk ishin komunistë, por mbështetën Luftën Antifashiste dhe rolin udhëheqës që kishte marrë Partia Komuniste Shqiptare në organizimin e saj. Xhaferri, Ramizi, Feriti, Isaku, Saliu, Muhameti, Nuriu, Xheviti dhe pjesëtarë të tjerë të familjes u rreshtuan në krahun e Lëvizjes Antifashiste. Ata nuk e shihnin luftën vetëm si një përplasje politike, por si një detyrë ndaj vendit në kushtet e pushtimit. Kjo zgjedhje do t'i kushtonte familjes shumë shtrenjtë.

Më 6 nëntor 1943, në sheshin e fshatit, pranë rrapeve shekullorë, burrave të familjes iu kërkua të hiqnin dorë nga rruga që kishin zgjedhur. Ndaj dhe u vranë Ramiz Kurti, Samedin dhe Hajdar Kurti, bij të Xhaferrit, Adil Kurti, nip i familjes, si dhe Thimi Llambi Bushi, mik i shtëpisë dhe bashkëfshatar. Bashkë me ta ranë dhe gratë e familjes: Jeko, Veize dhe Rahime u bënë pjesë e kësaj tragjedie familjare. Ato ishin gra që kishin familje, shtëpi dhe jetën e tyre, por që u gjendën përballë një dhune që nuk kurseu as pragun e shtëpisë. Në malet e Skraparit ra dhe Muhamet Kurti. Rënia e tij e shtoi më tej listën e humbjeve të familjes. Nuri Kurti, një tjetër pjesëtar i familjes, ishte plagosur më parë në betejën e Tendës së Qypit. Familja po humbiste bijtë e saj, por emri vazhdonte të mbetej i lidhur me qëndresën.

Vitet pas Çlirimit sollën përsëri përplasje dhe humbje. Në vitin 1948, Sefedin Kurti humbi jetën. Më pas, në vitin 1951, u vra edhe Xhevit Kurti, kryetar i Këshillit të fshatit Ngurrëz e Madhe. Një çetë me dëshmorë, ku shtëpia e tyre u bë fortifikatë, djemtë dhe burrat u bënë luftëtarë, ndërsa gratë u bënë dëshmitare të një tragjedie që kaloi pragun e shtëpisë. Emrat e atyre që ranë mbetën të gdhendur në kujtesën e Ngurrëzës së Madhe dhe të Myzeqesë, ku shtëpia u bë kështjellë, familja u bë histori.

Familje dhe figura të tjera dëshmore të Qarkut Fier

Në këtë vijimësi të traditave familjare dhe atdhetare përmenden disa figura të shquara:

- **Shefit Feti Goxhai (Hekali)** – komandant që ishte i pari në sulm, përfaqësues i një familjeje patriote me prejardhje nga fisi i Rrapo Hekalit.

- **Heroina Gero – bija e Shkozës së Fierit që sfidoi vdekjen.** Liri Gero, me guximin dhe vendosmërinë e saj, mori përsipër detyra të rëndësishme luftarake dhe drejtoi një skuadër partizane të Brigadës XVI Sulmuese. E plagosur rëndë gjatë luftimeve, nuk u tërhoq nga rruga e zgjedhur. E kapur nga nazistët, e torturuan dhe e dogjën barbarisht me benzinë. Në këtë traditë të heroizmit të grave myzeqare kujtohet dhe Feride Bega, trimëresha e Brigadës XVI Sulmuese.

- **At Spiro Saqellari** – kleriku dhe patrioti i shquar myzeqar, i betuar njësoj për fenë dhe Atdheun, ku në 74 vitet e jetës së tij, dëshmoi përkushtim të veçantë ndaj çështjes kombëtare dhe ra dëshmor për Atdhe.

- **Familja Shabanaj e Karbunarës së Lushnjës – babai dhe dy djemtë e tij.** Trimëria dhe qëndresa u shfaqën dukshëm në shtëpinë e Shabanajve, e cila dha tre dëshmorë: babanë dhe dy djemtë e tij. Ramë Shabani ishte djali që ra në luftën kundër pushtuesit; Nuri Shabani, luftëtar dhe drejtues i formacioneve partizane; ndërsa Mehmet Shabani, babai, u flijua së bashku me dy djemtë. Shtëpia e Shabanajve u bë vatër qëndrese, ku trimëria nuk mbeti vetëm fjalë, por u dëshmua përmes veprave dhe sakrificës më të madhe.

- **Familja Velo në fshatin Eskaj të Lushnjës** dha në luftë dy breza luftëtarësh: Todin, luftëtarin e vjetër, të birin, Vasilin, si dhe luftëtarin Profi Naun Boçi.

- **Vëllezërit Haxhiaj të Çorrushit**, Baftjar dhe Avni Haxhiaj, dy dëshmorë, dy jetë kushtuar Atdheut, përfaqësojnë një tjetër histori të dhimbshme sakrifice familjare.

- **Mehmet dhe Zeqo Boshnjaku, dy vëllezër, një ideal**. Të ndjekur nga serbët, u vendosën në Hamil të Fierit në vitin 1924. Të lidhur nga gjaku dhe dashuria familjare, u bashkuan në idealin e çlirimit të Atdheut. Historia e tyre është një tjetër dëshmi e përkushtimit atdhetar dhe e sakrificës familjare.

- **Nga familja Qystri, dy vëllezër që ranë për liri**. Të rritur në një fëmijëri të mbushur me varfëri dhe sakrifica, ata morën rrugën e partizanit në radhët e Brigadës I Sulmuese. Kadriu ra në Luftën e Vithkuqit, ndërsa Aqifi qëndroi i pathyer përballë torturave, dy vëllezër, një histori sakrifice dhe qëndrese.

- **Vëllezërit Bego, dy jetë të reja të kushtuara lirisë**. Nën dritën e zbehtë të kandilit, ata përjetuan vitet e varfërisë dhe të vështirësive, por u rritën me dëshirën për një jetë më të mirë. Nga grupet edukative kaluan në veprimtarinë antifashiste, ku Mihali braktisi ushtrinë fashiste dhe doli partizan, ndërsa Llambi, debatikasi i ri, nuk u thye nga torturat. Të dy morën rrugën drejt malit. Ata mbetën dëshmi e një sakrifice të përbashkët vëllazërore: dy jetë të ndërprera nga lufta, por një ideal që vazhdoi të jetojë në kujtesën e brezave.

- **Miço e Loni Papuçiu, një qëndresë përballë torturave dhe vdekjes**. Familja Papuçiu banonte në qytetin e Fierit, në një kasolle përdhese të mbuluar me kashtë, e rrethuar nga varfëria dhe mjerimi. Më 12 shtator 1944, Miço Papuçiu u plagos rëndë dhe më vonë ndërroi jetë me fjalët "Të rrojë Shqipëria e lirë!". Loni Papuçiu, në dhjetë ditë torture në burgun e Fierit, u dërgua në Berat e në burgun e Tiranës. U nis drejt kampit të Prishtinës, i cilësuar komunist i rrezikshëm. Në kamp nuk iu nënshtrua torturave të Gestapos, nuk e trembi plumbit fashist, më 23 tetor 1944, e dinte se po jepte jetën për një ideal të madh: lirinë e Atdheut.

Figura të tjera të heroizmit dhe të sakrificës

Dino Kalenja, komisari që ra në ballë të luftës, duke qëndruar në vijën e parë të luftimeve, ra dëshmor, duke u bërë pjesë e sakrificës së luftëtarëve të Mallakastrës; **Zoi Ndreko,** patrioti, mësuesi dhe luftëtari i Libofshës, figura që bashkoi në jetë tri misione: përhapjen e arsimit, luftën për pavarësi dhe qëndresën për çlirimin e vendit.

Historia e dëshmorëve të Qarkut Fier përfshin shumë figura, secila me rrugëtimin, veprën dhe sakrificën e vet: **Hysen Aranitasi**, nga ushtria fashiste në radhët e çlirimtarëve; **Gjergj Kondakçiu**, bujku që nuk iu nënshtrua armikut; **Andon Xoxa**, komisari që luftoi deri në frymën e fundit; **Xha Koli**, qëndresa e një patrioti 62-vjeçar; **Taip Ymeri**, fjala e guximshme përballë pushkës; **Skënder Libohova**, nga bankat e shkollës në fushën e luftës; **Kol Myzeqari**, komisari që mbeti në kujtesën e luftëtarëve; **Miti Qose**, nga Myzeqeja në luftimet e fundit për çlirimin e vendit; **Jashar Cakrani**, i rënë për idealin e lirisë; **Petro Sota**, ilegali që mbrojti sekretin deri në frymën e fundit; **Feridun Xhindole**, mësuesi që u bë komisar i partizanëve; **Hasan Axhemi**, pionieri që mbeti buzë rrugës si kujtim për brezat; **Uan Kondakçiu**, luftëtari që nuk u tërhoq nga pozicioni; **Namik K. Kamani**, në listën e komunistëve që në oborrin e burgut, nazistët hapën zjarr; **Nazif S. Zeqa**, ra në Sanxhak, në ballë të luftës…deri tek **Llambi Naun Bardhi**, që ra në krye të detyrës për zgjidhjen e një konflikti pronësie në vitin 2005.

Kujtesa që bashkon brezat

Dëshmorët e Qarkut Fier përfaqësojnë një histori të gjatë qëndrese, e cila nis me kryengritjet popullore të shekullit XIX, vijon me përpjekjet për pavarësi dhe mbrojtjen e trojeve shqiptare, me Luftën e Vlorës dhe Kryengritjen e Fierit, për të arritur një nga kulmet e saj në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Pas çdo emri qëndron një jetë, një familje dhe një histori sakrifice. Disa ishin të rinj që braktisën shkollën dhe jetën e zakonshme për të marrë armët. Të tjerë ishin bujq, mësues, patriotë, drejtues këshillash dhe njerëz të thjeshtë të fshatit. Kishte gra që u bënë luftëtare, familje që hapën dyert për partizanët dhe prindër që panë bijtë të niseshin për në luftë pa ditur nëse do të ktheheshin. Këta njerëz nuk i bashkonte e njëjta moshë, profesioni apo prejardhja shoqërore. I bashkonte bindja se Atdheu duhej të ishte i lirë. Për këtë ideal, shumë prej tyre dhanë jetën, ndërsa familjet e tyre mbartën për dekada dhimbjen e humbjes dhe krenarinë e sakrificës. Prandaj, historia e dëshmorëve të Qarkut Fier nuk mund të përmblidhet vetëm në numra, data dhe emra. Ajo duhet lexuar si histori e njerëzve, e familjeve dhe e komuniteteve që vunë fatin e tyre në shërbim të një çështjeje më të madhe se vetja. T'i kujtosh dëshmorët do të thotë të njohësh rrënjët e historisë sonë, të nderosh sakrificën e tyre dhe t'u përcjellësh brezave të rinj vlerat e atdhedashurisë, guximit dhe përgjegjësisë qytetare.

ENGJËLLUSHE SULA, GRUAJA QË E BËRI UNIFORMËN TRASHËGIMI

In memoriam – Nënkolonele Engjëllushe Sula, një nga pionieret e grave në uniformën shqiptare

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve



Në historinë e Forcave të Armatosura ka emra që nuk ruhen vetëm në dokumente, në fotografi apo në kujtesën e një brezi. Ata mbeten të gjallë edhe përmes rrugës që hapën dhe njerëzve që frymëzuan. **Nënkolonele Engjëllushe Sula** është një prej këtyre emrave.

Tre vite pas ndarjes së saj nga jeta, kujtimi i saj vjen si një homazh për një grua që e lidhi jetën me uniformën, dijen, familjen dhe shërbimin. Ajo ishte pjesë e **kursit të parë të femrave nën uniformë, në vitin 1967**, një prej atyre grave që në një kohë tjetër guxuan të hynin në një profesion që kërkonte disiplinë, sakrificë dhe një përkushtim të veçantë.

Por Engjëllushe Sula nuk ishte vetëm një nga gratë e para që veshi uniformën. Ajo e ndërtoi me dinjitet të gjithë rrugëtimin e saj profesional, duke shërbyer më pas si **pedagoge dhe punonjëse shkencore pranë Akademisë së Forcave të Armatosura**. Në këtë rol, përvoja e saj u kthye në dije dhe dija në formim për brezat e rinj të ushtarakëve.

Ajo i përkiste një brezi që nuk e gjeti rrugën të hapur. Përkundrazi, ishte ndër gratë që ndihmuan për ta hapur atë.

Gruaja pas uniformës

Por për ta kuptuar plotësisht figurën e nënkolonele Engjëllushe Sulës, duhet parë edhe përtej uniformës.

Ajo ishte **bashkëshortja e Gjeneralmajor Perlat Sulës**, një nga figurat e njohura të Forcave të Armatosura, i cili e përmbylli karrierën e tij si **Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes**.

Dy njerëz, dy karriera të lidhura ngushtë me ushtrinë, dy jetë të ndërtuara mbi disiplinën, përgjegjësinë dhe shërbimin ndaj vendit.

Por mbi të gjitha, ata ishin një familje. Në shtëpinë e Engjëllushe dhe Perlat Sulës, uniforma nuk ishte vetëm pjesë e profesionit. Ajo ishte pjesë e jetës së përditshme, e bisedave, e sakrificave dhe e vlerave që iu përcollën brezit të ri.

Dhe ky është ndoshta dimensioni më i bukur i trashëgimisë së Engjëllushe Sulës.

Nëna e dy vajzave që zgjodhën të njëjtën rrugë

Engjëllushe Sula ishte **nënë e dy vajzave**, të cilat, ashtu si prindërit e tyre, zgjodhën të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura.

Kjo nuk është një rastësi e zakonshme familjare. Është një histori trashëgimie. Vajzat e saj u rritën duke parë nga afër çfarë do të thoshte të jetoje me uniformën: përgjegjësinë, disiplinën, përkushtimin, sakrificën dhe krenarinë për t'i shërbyer vendit. Dhe kur erdhi koha për të zgjedhur rrugën e tyre, të dyja zgjodhën sërish uniformën.

Ana, vajza e tyre, është **mjeke ushtarake, obstetër-gjinekologe**. Në një tjetër dimension të shërbimit, ajo vijoi traditën familjare, duke vendosur dijen dhe profesionin në shërbim të njerëzve me uniformë.

Ndërsa **Nënkolonele Alda Perlat Sula**, vajza tjetër e familjes, është bërë një emër i spikatur në radhët e grave të Forcave të Armatosura. Ajo është përzgjedhur ndër **35 nënkolonelet e Republikës**, si një nga vajzat dhe gratë e suksesshme të Forcave të Armatosura për vitin 2020, edhe sot vazhdon të shkëlqejë në çdo detyrë të ngarkuar.

Kështu, rruga e Engjëllushe Sulës nuk përfundoi me karrierën e saj. Ajo vazhdoi te vajzat.

Dhe kjo e bën historinë e saj edhe më të veçantë.

Një grua që në vitin 1967 hyri ndër të parat në uniformë, një bashkëshorte e një gjeneralmajori me vlera të veçanta të Forcave të Armatosura, një nënë e dy vajzave ushtarake dhe një pedagoge që kontribuoi në formimin e brezave të ushtarakëve, katër dimensione të një jete që lidhen në një të vetme: **shërbimin**.

Një nënë që nuk la vetëm kujtime

Ndoshta për familjen, Engjëllushe Sula nuk do të kujtohet së pari për gradën, detyrën apo vitet e shërbimit.

Do të kujtohet si nënë.

Si gruaja që rriti dy vajza dhe i pa ato të zgjedhin të njëjtën rrugë.

Si bashkëshortja që ndau me Gjeneral Perlat Sulën vitet e një karriere të gjatë ushtarake.

Si gruaja që dinte të bashkonte kërkesat e profesionit me përgjegjësitë e familjes.

Për kolegët dhe ish-bashkëpunëtorët, ajo mbetet oficerja, pedagogia dhe punonjësja shkencore.

Për familjen, ajo është nëna dhe bashkëshortja.

Për Forcat e Armatosura, ajo është një nga gratë që i përkasin historisë së hershme të femrave në uniformë.

Një jetë që vazhdon në brezin pasardhës

Historia e Engjëllushe Sulës është edhe historia e një kohe që ndryshoi. Kur ajo veshi uniformën në vitin 1967, gratë në Forcat e Armatosura ishin ende një prani e re. Sot, dekada më vonë, gratë janë pjesë e të gjitha niveleve të institucionit ushtarak, në role të ndryshme profesionale dhe drejtuese. Mes këtyre dy kohëve qëndrojnë edhe gra si Engjëllushe Sula. Ato nuk flasin më përmes zërit të tyre, por përmes gjurmës që kanë lënë.

Në rastin e saj, kjo gjurmë është veçanërisht e prekshme: është në historinë e Forcave të Armatosura, në dijen që përcolli si pedagoge, në jetën e bashkëshortit të saj, në rrugën e dy vajzave dhe në kujtesën e atyre që e njohën.

Tre vite pas largimit të saj, kujtimi nuk vjen vetëm përmes dhimbjes së mungesës. Vjen edhe përmes krenarisë.

Krenarisë për një grua që e jetoi jetën me dinjitet.

Për një oficere që ishte pjesë e brezit të parë të grave në uniformë.

Për një pedagoge që kontribuoi në formimin ushtarak.

Për një bashkëshorte që ndau me një gjeneralmajor një jetë të tërë të lidhur me Forcat e Armatosura.

Dhe mbi të gjitha, për **një nënë që la pas dy vajza ushtarake**, të cilat vazhdojnë të mbajnë në uniformë atë që nëna e tyre e kishte bërë pjesë të identitetit të saj.

Engjëllushe Sula u nda nga jeta, por ajo që ndërtoi nuk u shua me të.

Ajo mbeti në historinë e grave shqiptare në uniformë, në kujtesën e Forcave të Armatosura dhe, mbi të gjitha, në dy vajzat e saj që vazhdojnë rrugën që ajo nisi.

Ndoshta ky është homazhi më i bukur për një grua: **të mos mbetet vetëm kujtimi i saj, por të vazhdojë jeta e vlerave që ajo mbolli.**

Mërkur Bua Shpata, Gjenerali Arbëror i Luftërave të Evropës dhe Arti Luftarak i Stratiotëve



MARIN MEKSI
KOLONEL (HONORIFIK)

Ka emra që historia i shkruan me bojë, dhe ka emra që i shkruan me thundra kuajsh mbi fushat e betejës. Mërkur Bua Shpata (1478 – rreth 1542) i përket këtyre të dytëve. Ai ishte komandant stratiot, gjeneral i një kalorësie arbërore që ua jepte shpatën mbretërve të Evropës, siç e donte profesioni i kohës. Për gati gjysmë shekulli, flamujt nën të cilët luftoi ndërruan ngjyrë: herë të Venedikut, herë të Milanos, herë të Francës e herë të Perandorisë Gjermane. Vetëm burrat që i shkonin pas mbetën gjithmonë të njëjtët, arbërorë. Mbreti i Francës, Louis XII (Luigji XII), i mahnitur nga trimëria e tij, e nderoi me titullin "Kont i Aquinos dhe Roccaseccas".

Poeti që e shoqëroi nëpër luftëra, Tzanes Koronaios (Xane Koroneo), i këndoi si një Pirro të ri, si Akil e si Aleksandër. Por përtej vargjeve, jeta e tij rrëfen diçka më të vërtetë se legjenda. Ajo tregon se si një djalë arbëror nga brigjet e Moresë arriti të komandonte mijëra kalorës në ushtritë më të fuqishme të kohës. Njëkohësisht, tregon se si mënyra e luftës së maleve ballkanike erdhi e ndryshoi fushat e Evropës Perëndimore.

Mërkuri erdhi në jetë në vitin 1478, në Nafplio të Peloponezit, aty ku deti i kaltër përplaset nën shkëmbinjtë e thepisur të kodrës së Palamidit. Venecianët e quanin qytetin Napoli di Romania dhe e mbanin si një nga gurët e çmuar të zotërimeve të tyre në Lindje. Por në rrugicat e tij, në arat e në kullotat përreth, flitej arbërisht, sepse arvanitasit përbënin shumicën e popullsisë. Prej këtej Venediku mblidhte stratiotët e vet, luftëtarë që rriteshin mbi shalë që fëmijë. Mërkuri vinte nga familja fisnike Bua, degë e familjes Meksi, dhe në gjakun e tij jetonte kujtimi i Gjin Bua Shpatës, sundimtarit arbëror që kishte mbajtur Despotatin e Artës në shekullin XIV.

I ati, Pjetër Bua, ishte një nga prijësit e shqiptarëve të Moresë, një komandant stratiotësh emri i të cilit njihej mirë në Venedik. Kur ai vdiq, i biri ishte ende djalë. Rreth vitit 1489, Mërkuri la pas detin e Nafplios dhe mori rrugën e Venedikut, për të kërkuar fatin aty ku e kishte kërkuar edhe i ati. Burimet e vjetra thonë se në fëmijëri e quanin Morik, dhe se në Venedik emri iu kthye në Mercurio. Në disa dokumente shfaqet edhe si Maurizio, sikur vetë historia të mos ishte e sigurt si ta thërriste.

Familja i dha më shumë se një emër: i dha një rreth burrash besnikë. Bua, Buziki, Bokali, Reneshi e Manesi luftonin krah për krah, lidhnin krushqi mes familjeve të tyre dhe i varrosnin të vdekurit në të njëjtat kisha. Prandaj Mërkuri e ngrinte trupën e tij gjithmonë me arbërorë, shpesh nga e njëjta krahinë, me njerëz që ia njihte fytyrën dhe fisin. Dhe kur e ndiente se rreziku po afrohej, ai thërriste menjëherë stratiotë të rinj nga Nafplio.

Ishte mëngjesi i 6 korrikut 1495, dhe lumi Taro rridhte i cekët pranë fshatit Fornovo. Mbreti i Francës, Karli VIII, po kthehej nga Napoli, ndërsa "Lidhja e Shenjtë", me Venedikun në krye, i kishte zënë rrugën. Mërkuri, ende shtatëmbëdhjetë vjeç, printe stratiotët. Përplasja kryesore zgjati rreth një orë, por la pas mijëra të vrarë nga të dyja anët. Një vit më vonë, i riu kalorës udhëhiqte tashmë rreth 300 stratiotë kundër fiorentinëve në fushat përreth Pizës.

Francezët, që e kishin parë nga afër se si luftonte, e donin tani në krahun e tyre. Në vitin 1503, pranë gjeneralit La Trémoille, ai u lëshua mbi kalorësit spanjollë te Roccasecca dhe i theu. Luigji XII e bëri kont të Roccaseccas dhe Aquinos dhe i dorëzoi komandën e kalorësisë së lehtë. Në vitin 1506, Papa Juli II e ndiente fronin e tij të kërcënuar nga zotërit e fuqishëm të Bolonjës, familja Bentivoglio. Mbreti francez dërgoi Mërkurin për ta shpëtuar Atin e Shenjtë nga rreziku, dhe kalorësit arbërorë e bënë këtë me sukses. Papa mirënjohës i fali një brez të artë dhe 1000 florinë ari. Një vit më pas, kur Gjenova u ngrit kundër mbretit francez, ishte sërish Mërkuri ai që e shtypi kryengritjen.

Pastaj ai mori rrugën e veriut dhe hyri në shërbim pranë perandorit Maksimilian I. Luftoi në fushat e mjegullta të Flandrës kundër Karlit të Egmondit, dukës së Geldernit, dhe më pas zbriti sërish në Itali, këtë herë kundër Venedikut. Në vitin 1510 perandori i dhuroi një flamur të kuq me shqiponjë të zezë, një shenjë që i ngjante çuditërisht flamurit të atdheut të të parëve. Por këto ishin edhe vitet më të hidhura: më shumë se një herë, përballë tij qëndronin bashkatdhetarë që luftonin për Venedikun, si Domenik Buziki. Kronisti venecian Marino Sanudo shkruan se arbërorët e njihnin lidhjen e gjakut që i bashkonte, dhe se nuk e kërkonin vdekjen e njëri-tjetrit, edhe kur ndodheshin në ushtri kundërshtare. Mërkuri e tregoi këtë me vepra. Pas fitores së madhe në Agnadello, në maj të vitit 1509, shumë ushtarë venecianë u zunë rob, dhe mes tyre kishte mjaft arbërorë. Ishte ai që u ngrit dhe e pengoi ekzekutimin e tyre, sepse nuk mund të lejonte që shpata e huaj të binte mbi qafat e vëllezërve të tij.

Ishte miku i tij i vjetër, Bartolomeo d'Alviano, ai që e bindi të kthehej. Mërkuri u kthye pranë Republikës së Shën Markut si një bir plëngprishës që pritet me nderime. Senati i dha titullin e fisnikut venecian, pagë mujore dhe një trupë prej 200 kalorësish e 100 këmbësorësh. Në Frassine ai kapi rob komandantin spanjoll Alfonso Carvajal, ndërsa në Creazzo ndihmoi të ndalej vala e këmbësorisë spanjolle.

Kulmi i jetës së tij erdhi në shtator të vitit 1515, në fushat me vreshta pranë Marignanos, në atë që bota do ta quante "beteja e gjigantëve". Rreth 22 mijë zviceranë, këmbësoria më e frikshme e Evropës, marshuan nga Milano në kolona të ngjeshura me heshta të gjata. Gjithë ditën e 13 shtatorit dhe deri në mesnatë, nën dritën e hënës, francezët e Fransuait I mezi rezistuan. Mëngjesin e dytë, nga horizonti u shfaq kalorësia veneciane e



d'Alvianos, dhe mes saj Mërkuri me rreth 400 kalorësit e tij. Goditja e tyre në krahun e zviceranëve e ktheu fatin e betejës. Mërkuri u plagos, por nuk u ndal: i ndoqi kundërshtarët në tërheqje dhe u mori katër topa dhe dy flamuj.

Kur pluhuri ra, fusha ishte e mbuluar me trupa. Rreth 10 mijë helvetë mbetën të vrarë mbi atë tokë, pothuajse gjysma e atyre që kishin ardhur, ndërsa francezët dhe aleatët e tyre humbën rreth 5 mijë burra. Për Zvicrën kjo ishte një plagë që nuk u harrua kurrë. Një vit më pas, kantonet nënshkruan me Francën "Paqen e Përjetshme" dhe hoqën dorë përgjithmonë nga ëndrra e zgjerimit me shpatë. Pikërisht aty, mbi atë fushë të përgjakur, lindi asnjanësia zvicerane. Që nga Marignano, Zvicra nuk mori më pjesë në luftërat e Evropës si palë, dhe e ruan këtë asnjanësi edhe sot, pas më shumë se pesë shekujsh. Fuqitë evropiane e njohën atë zyrtarisht në Kongresin e Vjenës, në vitin 1815, por rrënjët e saj qëndrojnë në kockat e helvetëve që mbetën në Marignano. Kështu, kalorësit arbërorë të Mërkurit u bënë pjesë e lindjes së një prej traditave më të gjata politike të Evropës.

Dy vjet më pas, tashmë komandant i lartë i Venedikut, Mërkuri mori pjesë në rimarrjen e Brescias. Por fati i luftëtarit nuk është gjithmonë fitore. Vite më vonë, ndërsa mbronte Milanon, kali i tij u rrëzua dhe ai ra në duart e Federico Gonzagës, zotit të Mantovës. Gonzaga e dërgoi në Mantova, por emri i Mërkurit kishte arritur aty përpara tij. Nga nderimi për famën dhe trimërinë e kundërshtarit, Gonzaga e liroi, pa kërkuar as shpërblim, as shkëmbim robërish.

Kur flokët iu zbardhën, Mërkuri e la gradualisht shalën e kalit dhe u vendos në Treviso, ku ngriti shtëpinë e tij. Gruaja e parë, Maria Bokali, bija e Niko Bokalit dhe mbesë e Arianitëve, u nda nga jeta në vitin 1524. Më pas ai u martua me fisniken veneciane Elisabetta Balbi, e cila i fali katër fëmijë. Njërin prej djemve e pagëzoi Pirro, si për t'i kujtuar vetes dhe botës se nga cili trung vinte: nga toka e mbretit të lashtë të Epirit.

Por zemra e tij nuk e harroi kurrë Ballkanin. Në vitin 1533, sipas Koronaios-it, ai u shkroi sundimtarëve të krishterë dhe kërkoi të drejtonte një aleancë të madhe kundër osmanëve, i bindur se do t'i thyente. Në vitin 1537, kur osmanët u tërhoqën nga Korfuzi, ai i propozoi Senatit venecian një fushatë në More, në tokën ku kishte lindur.

Mërkuri ndërroi jetë në Treviso rreth vitit 1542 dhe u preh në kishën e Santa Maria Maggiore. Mbi varrin e tij, mbishkrimi latin e quan "Kont, nga princat e Peloponezit, prijës i kalorësve epirotë". Piktori Lorenzo Lotto la portretin "Fisniku" (*Gentiluomo*), ku sipas disa studiuesve na sheh ende sot, me beretë të zezë, vetë Mërkuri.

Trashëgimia e tij më e madhe është emri dhe bëmat. Pas Fornovos, Franca, Spanja, Perandoria e madje edhe Anglia nisën të kërkonin kalorës nga Ballkani. Taktikat e tyre lindën kalorësinë e lehtë evropiane, nga kalorësit e lehtë francezë e deri te husarët e shekujve të mëvonshëm. Kështu, në thundrat e kuajve që përshkuan fushat e Evropës, ka mbetur edhe gjurma e një djali arbëror nga Nafplio, Mërkur Bua Shpata.

Strategjitë e luftës së Mërkurit dhe stratiotëve

Stratiotët nuk sollën në Itali vetëm kuajt dhe shpatat e tyre. Ata sollën një mënyrë lufte të farkëtuar në shekuj, në përplasjet e gjata mes bizantinëve, arbërorëve, sllavëve dhe osmanëve në luginat e Ballkanit. Historiani Nicholas Pappas shkruan se ata sulmonin dhe tërhiqeshin si vetëtima, ngrinin prita, iknin me dinakëri dhe ktheheshin me kundërsulme, taktika që kalorësit e Perëndimit pothuajse nuk i njihnin. Ja si dukej ky art lufte në fushat e Mërkurit dhe të shokëve të tij.

1. **Ikja e shtirur.** Kalorësia e rëndë frënge sulmonte si një mur hekuri, e fuqishme, por e ngadaltë dhe e lodhur shpejt. Stratiotët i dilnin përpara, godisnin dhe pastaj kthenin kuajt sikur po iknin të tmerruar. Kalorësit e armikut, të dehur nga fitorja e afërt, u vërsuleshin pas dhe shpërndaheshin nëpër fushë. Atëherë stratiotët ktheheshin papritur, si një tufë ujqish, dhe i godisnin një nga një, nga krahët e nga pas.
2. **Ngacmimi pa pushim.** Pak ditë para Fornovos, më 1 korrik 1495, stratiotët u lëshuan mbi kolonat franceze për t'i provuar. Natën e 5 korrikut, ndërsa francezët hanin bukën e zezë që kishin gjetur në fshat, ata ranë sërish mbi kamp. Qëllimi nuk ishte fitorja e menjëhershme. Ishte lodhja, frika, netët pa gjumë, që e dobësonin armikun para se të binte goditja e vërtetë.
3. **Perdja e syve.** Stratiotët qëndronin mes dy ushtrive si një perde e padukshme. Ata i kapnin ose i dëbonin zbuluesit francezë, aq sa Karli VIII marshonte i verbër, pa ditur as sa e madhe ishte ushtria kundërshtare, as ku ndodhej.
4. **Goditja nga krahët.** Në Fornovo, stratiotët e Duodos kapërcyen kodrat në heshtje për t'i rënë pararojës franceze nga anët. Kalorës të tjerë të lehtë kaluan lumin Taro më lart e më poshtë, për t'i dalë armikut pas shpine, aty ku ai nuk e priste.
5. **Karvani dhe mësimi i tij.** Në Fornovo, stratiotët u vërsulën mbi karvanin e madh të plaçkës franceze, që ecte i rëndë dhe i ruajtur dobët. Por shkëlqimi i arit i verboi: ata u morën me plaçkën dhe dolën nga beteja, ndërsa francezët çanë rrugën dhe shpëtuan. Mërkuri e mbajti mend këtë mësim. Në betejat e tij të mëvonshme, trupa e tij qëndronte e disiplinuar deri në fund.
6. **Prita dhe kapja e prijësve.** Në Rovigo ai u shfaq papritur para spanjollëve dhe kapi prijësin e tyre. Në Frassine zuri rob komandantin Alfonso Carvajal. Te Conselve, me vetëm 200 stratiotë, shpartalloi një trupë spanjolle dhe i mori robër të gjithë. Një ushtri pa prijës është si një trup pa kokë, dhe Mërkuri e dinte këtë mirë.
7. **Rezerva që vendos fatin.** Në Marignano, kalorësia veneciane nuk u hodh në zjarrin e ditës së parë. Ajo erdhi në agimin e të dytës, kur zviceranët ishin rraskapitur nga një natë e tërë luftimesh. Goditja e saj në krah dhe në shpinë e detyroi këmbësorinë më të frikshme të Evropës të tërhiqej.
8. **Bashkimi i armëve.** Në vitin 1513, në Verona, Mërkuri udhëhiqte 400 kalorës, 3000 këmbësorë dhe tetë topa të vegjël. Kalorësi i Ballkanit e kishte kuptuar se lufta po ndryshonte, dhe se shpejtësia e kalit duhej të ecte bashkë me forcën e këmbësorisë dhe gjëmimin e topave.
9. **Trupa e vogël, zemra e madhe.** Mërkuri nuk e mbante kurrë trupën mbi disa qindra burra dhe i zgjidhte vetë, shpesh nga të njohurit e Nafplios. Një trupë e tillë lëvizte si era, fshihej si hija dhe nuk shpërbëhej nga paniku. Atë e mbanin bashkë jo vetëm paga, por gjaku, fisi dhe besa.
10. **Frika dhe bujaria.** Stratiotët ktheheshin shpesh nga betejat me kokat e armiqve si trofe, sipas një zakoni të vjetër ballkanik, dhe kronistët francezë pohojnë se kjo i tmerronte ushtarët e tyre. Por Mërkuri dinte të ishte edhe bujar. Në Kremona ai i liroi robërit pa kërkuar asnjë monedhë, edhe pse kondotieri Trivulzio ishte gati të paguante shtrenjtë për ta. Veronezit Giacomo Mamalucco ia fali jetën me fjalën e besës. Vetëm kur ky e theu besën, Mërkuri e ndëshkoi në betejën tjetër, sepse për një arbëror fjala e dhënë ishte më e shenjtë se jeta.

Armët dhe luftimi trup me trup:

Stratioti nuk ishte kalorës i mbyllur në hekur. Ai ishte i lehtë, i shpejtë, i lidhur me kalin e tij si një trup i vetëm. Mbante shtizë, shpatë të gjatë të lakuar, topuz dhe kamë dhe vishej me një përzierje rrobash lindore, bizantine e perëndimore. Mbi gjoks hidhte një parzmore me thurje hekuri ose të mbushur me pambuk, në kokë një përkrenare të lehtë ose një kapelë të kuqe, prej së cilës italianët i quanin *capelletti*, "kapuçkuqtë" dhe mjekër të gjatë e të dendur.

Armët e kalorësit arbëror:

- **Arzegaja, shtiza me dy maja.** E shkurtër dhe e lehtë, me majë hekuri në të dyja anët, ajo kërcente në dorën e stratiotit si një gjarpër. Ai e mbante me një dorë dhe godiste nga lart ose nga poshtë, pa e mbërthyer nën sqetull si kalorësit e rëndë. Kur maja e përparme thyhej në trupin e armikut, ai e rrotullonte shtizën dhe vazhdonte me majën tjetër.
- **Shpata e lakuar.** Ajo nuk godiste si sëpatë, por rrëshqiste si drapër teksa kali kalonte me vrap pranë armikut. Synonte vendet ku hekuri nuk mbronte: qafën, krahët, duart, kofshët dhe frerët e kalit.
- **Topuzi.** Ishte përgjigjja e Ballkanit ndaj forcave të blinduara të Perëndimit. Teha nuk e çante dot pllakën e çelikut, por topuzi me fletë e shtypte përkrenaren dhe e linte kalorësin të shushatur mbi shalë.
- **Kama.** Ishte fjala e fundit e çdo përleshjeje, kur burrat ngatërroheshin trup me trup ose rrokulliseshin nga kuajt në baltë.
- **Mburoja.** E vogël, prej druri e lëkure, e lidhur pas krahut, që dora të mbetej e lirë për frerët.

Arti i përleshjes në kohën e Mërkurit

Si luftohej trup me trup në Itali e dimë nga librat e mjeshtërve të armëve. Fiore dei Liberi, një kalorës nga Friuli, shkroi rreth vitit 1410 "Lulja e Betejës" (*Fior di Battaglia*), ku mëson luftimin më këmbë e mbi kalë, me forca të blinduara e pa to. Filippo Vadi e vazhdoi këtë traditë, ndërsa në vitin 1536, kur Mërkuri ishte ende gjallë, mjeshtri bolonjez Achille Marozzo botoi *Opera Nova*, një nga librat e parë të shtypur për artin e armëve. Në faqet e tyre gjallojnë teknikat e atyre me të cilët Mërkuri luftoi, si kundërshtarë dhe si aleatë.

1. **Largësia dhe afërsia.** Fiore e ndante luftimin në "lojë të gjerë" (*zogho largo*), kur armiqtë goditen nga larg me armë, dhe "lojë të ngushtë" (*zogho stretto*), kur trupat ngjiten me njëri-tjetrin. Në afërsi, shpata linte vendin te kapja dhe te kama.
2. **Shtiza kundër shtizës.** Kalorësi i mirë e shmangte majën e armikut duke e shtyrë anash me shtizën e vet, dhe në të njëjtin çast godiste. Këtu kalorësi i lehtë kishte epërsi, sepse e kthente kalin më shpejt se një kalorës i rënduar nga hekuri.
3. **Rrëzimi nga shala.** Kur dy kalorës kalonin aq afër sa preknin njëri-tjetrin, nisnin kapjet (*abrazare*): krahu, frerët ose qafa e kundërshtarit kapeshin me forcë për ta rrëzuar. Një kalorës i blinduar që binte përtokë mezi ngrihej dhe mbetej si një "breshkë e përmbysur".
4. **Kama në të çarat e hekurit.** Mbi armikun e rrëzuar, kama kërkonte pikat e dobëta: nën sqetull, vrimat e përkrenares, fytin, nyjat e pllakave.
5. **Shpata, mburoja dhe manteli.** Marozzo mëson luftimin me shpatë dhe mburojë të vogël (*brocchiere*), me shpatë dhe kamë, apo me kamë dhe mantel të mbështjellë rreth krahut. Këto ishin armët e këmbësorëve dhe të dyluftimeve, si ai në të cilin Mërkuri vrau kapitenin Faccendino, që e kishte fyer më parë.

Stratiotët nuk lanë libra. Arti i tyre kalonte nga babai te biri, nga shala e kalit në shalë, nga një betejë në tjetrën. Librat italianë na tregojnë vetëm me kë përballeshin, dhe sa e madhe duhet të ketë qenë mjeshtëria e atyre që gjunjëzuan Evropën.

Përtej oqeanit, zemra mbetet në Shqipëri

Thonë që dashuria nuk i njeh kilometrat, dhe e tillë është për shqiptarët që jetojnë përtej oqeanit, Atdheu nuk është vetëm një vend i lënë pas. Ai është kujtesë, gjuhë, flamur, këngë, kujtime fëmijërie, prindër, shokë, miq, rrugë të njohura dhe mbi të gjitha një ndjenjë që udhëton bashkë me ta kudo ku jeta i ka çuar.

Kjo ndjenjë bëhet edhe më e fortë te brezi i **ish-skënderbegasve**, djemve dhe vajzave që dikur u mblodhën në bankat e së njëjtës shkollë, që u rritën me disiplinën, shoqërinë, sakrificën dhe dashurinë për uniformën e për Atdheun. Shumë prej tyre sot jetojnë në vende të ndryshme të botës, por lidhja me njëri-tjetrin dhe me Shqipërinë nuk është tretur nga koha. Përkundrazi, vitet dhe largësia duket se e kanë bërë edhe më të çmuar atë që i bashkon.

Në ditët e festave kombëtare, kjo lidhje merr një kuptim të veçantë. Ish-skënderbegasit mblidhen, takohen, përqafohen, kujtojnë vitet e rinisë, flasin për shokët e tyre, për familjet, për jetën dhe, mbi të gjitha, ngrenë flamurin kuqezi në zemrat e tyre. Ata krijojnë atje ku jetojnë një copëz Shqipëri, jo vetëm për vete, por edhe për fëmijët, nipërit e mbesat, duke u përcjellë brezave të rinj gjuhën, traditat dhe dashurinë për vendin e origjinës.

Pikërisht këtë atmosferë sjell në këtë shkrim kapiteni (R) **Veri Taushllari**, ish-skënderbegas, mik dhe bashkëpunëtor i hershëm i Shtypit Ushtarak. Përmes rrëfimit të tij nga Nju Jorku, ne nuk lexojmë thjesht për një festë. Lexojmë për një komunitet që ruan kujtesën, për njerëz që edhe pas shumë vitesh vazhdojnë të ndihen pjesë e një familjeje të madhe dhe për një brez që, pavarësisht vendit ku jeton, nuk e ka humbur busullën e dashurisë për Shqipërinë.

Është një rrëfim i ndjerë, njerëzor dhe plot jetë. Në të janë shokët e vjetër, familjarët, ish-ushtarakët, fëmijët dhe nipërit e tyre, janë himnet, flamuri, këngët e vallet, mirënjohjet dhe kujtimet. Është Nju Jorku, por në atë sallë, për disa orë, është edhe Shqipëria.

Redaksia e Shtypit Ushtarak e sjell këtë dëshmi me respekt të veçantë për të gjithë ish-skënderbegasit që jetojnë përtej oqeanit dhe që, sa herë mblidhen në ditët e shënuara të kombit, na dëshmojnë se **Atdheu nuk është vetëm vendi ku jeton; është vendi që jeton brenda teje.**

NJË COPËZ SHQIPËRI NË NJU JORK



KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

Si në ato kohëra, kur borizanët e Shkollave na thërrisnin të mblidheshim, edhe këtë të diel iu përgjigjëm thirrjes së organizatorëve dhe me atë mallin për njëri-tjetrin dhe dashurinë e pashuar nga vitet dhe kilometrat për Atdheun, takohemi e përqafohemi në këtë lokal plot dritë e ajër.

Gëzim Shentolli, Presidenti i Shoqatës, Dirka Xhakolli, zëvendësja e tij dhe Përparim Seitaj, kryetar i Degës së Kuinsit, bëjnë mikpritësin.

Ushtarakët me banim në Nju Jork e rrethinat, me familjarët e tyre – e për gëzimin tonë shumica të shoqëruar nga fëmijët, nipat e mbesat – pasi takohen e çmallen me njëri-tjetrin, pyesin për gëzimet, hallet e shëndetin, zënë vend në tavolinat e shtruara si për dasmë.

Ja ku hyn në sallë Krisulla Prifti, që vitet nuk e ndalojnë të bashkohet me "më të rinjtë", ne, 60 e 70-vjeçarët. E takojmë dhe e urojmë edhe për një akt vërtet sa të bukur aq të lodhshëm e me përgjegjësi: përgatitjen dhe botimin e një libri për Dëshmorin e Atdheut Llukan Sokrat Ceka, lënë dorëshkrim nga bashkëshorti i saj i ndjerë, Virgjili.

Ja ku vjen dhe Haxhi Sejdarasi, e pastaj Flutura Zeka me nënën dhe mbesën e saj, Blerta Boriçi me familjen, Xhevat Misku... e radha zgjatet e zgjatet.

Ja ku vjen dhe Astrit Huskaj, Kryetari i Organizatës së Veteranëve të UÇK-së për SHBA-në dhe Kanadanë, me një pako në duar. Ai asnjëherë nuk harron që, bashkë me përshëndetjet e "qendrës", siç shprehet ai, d.m.th. Selisë Qendrore të OVL të UÇK-së në Prishtinë, kryetarit Hysni Gucati dhe Komandantëve që padrejtësisht po gjykohen në Hagë, të vlerësojë me Certifikata Mirënjohjeje anëtarë të Shoqatës sonë.

Këtë herë ato i shoqëron me një Medalje të UÇK-së që jepet në emër të Familjes Martire të Jasharajve, dhe Agim Pira, Miltjadh Papadhima dhe autori i këtyre radhëve ndihen krenarë për vlerësimin.



Salla duartroket ardhjen e kolegëve tanë të Forumit të Ushtarakëve, pjesë e Shoqatës Atdhetare "Bijtë e Shqipes" në Filadelfia. Lidhja dhe veprimtaritë e përbashkëta mes dy Shoqatave tona është nga gjërat më të bukura që ne tregojmë, në një mjedis ku, jo në pak raste, mes organizatave të emigrantëve, e madje edhe brenda një organizimi, ka mosmarrëveshje e deri përçarje.

Po veçoj në këtë tablo punën që kanë bërë drejtuesit e mëparshëm të tyre, Bujar Hasani e Gëzim Mustafa, Eqerem Murati, Haki Çollaku, Ali Sopi, Hys Hasa e Lutfi Brami, për t'u lënë ca merita lidhjeve të mia me shokun tim të hershëm, nga viti i largët 1971, kur u ulëm në bankat e të njëjtës klasë në Shkollën "Skënderbej", Petrit Zanin.



Lidhje këto që jo vetëm nuk u ndërprenë as në vitet kur shërbyem në repartet e Ushtrisë Shqiptare, unë në Korçë e Berat e Petriti në Fier dhe si pedagog në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, e as këtu në emigracion. Por ato reflektuan edhe në marrëdhëniet dhe veprimtaritë e përbashkëta të Shoqatave që krijuam e drejtuam.

Tingujt e **"The Star-Spangled Banner"**, dhe **"Rreth Flamurit të Përbashkuar"** mbushin sallën dhe pjesëmarrësit, me dorë në zemër, nderojnë Atdheun që i lindi dhe i rriti, dhe Atdheun që i priti e u dha një mundësi atyre e sidomos fëmijëve të tyre.

Ndërsa luhet Himni Amerikan, shikoj se sa i befasuar dhe i mrekullueshëm reagon Billi, bashkëshorti i vajzës sime, Anës. Dhe e njëjta ndodh me amerikanë të tjerë, nuse e dhëndurë të kolegëve të mi, një realitet që na duhet ta pranojmë.

E pastaj muzika, këngët e vallet tona i japin edhe më shumë dritë e gjallëri festës. Valle e këngë të Veriut e Jugut, lirike dhe epike, të vjetra e të reja, krijojnë një mjedis festiv të mrekullueshëm. Gjithkush ndihet mirë dhe i gëzohet faktit që jemi bashkë, e së bashku krijojmë një copëz Shqipëri këtu në Nju Jork.

Por nuk jemi vetëm ne.

Në kohën që ne festojmë këtu, njoftohemi se në mjediset e 32BJ, një nga Sindikatat me më shumë anëtarë me kombësi shqiptare në NY, gjithashtu po festohet Dita e Shqipërisë. Edhe në mjediset e Bashkisë së Filadelfias dhe të Nju Jorkut shënohet kjo Ditë, me ngritjen e Flamurit dhe koncerte me këngë e valle shqiptare.

Dhe jo larg nga lokali ynë, një tjetër ushtarak shqiptar, ish-skënderbegas, ing. Qemal Zylo, ka mbledhur në festë nxënësit e shkollave shqipe "Alba Life", që ai drejton në të



pesë qytetet e Metropolit njujorkez.

E gjithë këto ditë, kjo javë që po vjen, do të jetë e tillë, mbushur me veprimtari.

Por le të tregojmë edhe për disa momente nga festa jonë. Presidenti i Shoqatës, Gëzim Shentolli, në emër të Bordit, vlerëson me Certifikatë Mirënjohjeje disa anëtarë të Shoqatës.

Në pamundësi për të qenë vetë, Mirënjohjen për Sulejman Avdinë e merr vajza e tij, Valbona, oficere dhe ajo. Dhe, për ta treguar veten tamam shkodrane, pasi falënderon, Valbona tregon me humor një moment nga jeta në Ushtrinë Shqiptare, e salla shpërthen në të qeshura.

Ja një mirënjohje për Përparim Seitajn, një nga anëtarët më aktivë dhe organizatorët më të aftë të Shoqatës, që në vite ka dhënë një kontribut të vlefshëm në veprimtaritë e saj, bashkë me shoqen e tij, Artën, oficere edhe ajo. E kështu, mes këngëve, valleve e momenteve të gëzuara, kalojnë ato 5-6 orë feste dhe ne ndahemi me njëri-tjetrin me dëshirën dhe urimin për t'u takuar në ditë të tjera feste e gëzime.

Dhe patjetër me dëshirën që nga Shqipëria të marrim lajme të mira në rrugën e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian, në rritjen e mirëqenies së njerëzve dhe stabilitetin politik e social.

Gëzuar!

Adriatiku nën dritat artificiale, si po kërcënohet një nga detet më të rëndësishëm të Europës



Një det që prej shekujsh ka qenë urë mes popujve, tregtisë dhe qytetërimeve, sot po përballet me një kërcënim të padukshëm. Nuk vjen nga ndotja plastike, derdhjet industriale apo mbipeshkimi, por nga drita. Studiuesit paralajmërojnë se ndriçimi artificial që përhapet nga qytetet, portet dhe zonat turistike përgjatë bregdetit italian po e kthen Adriatikun në një nga detet europiane më të ekspozuara ndaj ndotjes së dritës artificiale.

Një problem që nuk ndalet në vijën bregdetare

Për shumë vite, ndotja nga drita është konsideruar kryesisht si një problem i qyteteve dhe i qiellit të natës. Megjithatë, kërkimet më të fundit tregojnë se efekti i saj shkon shumë më larg. Drita e prodhuar nga rrugët bregdetare, resortet turistike, portet detare, hotelet dhe infrastrukturat urbane nuk mbetet në tokë. Ajo përhapet mbi sipërfaqen e detit dhe depërton në ujë, duke ndryshuar kushtet natyrore që kanë udhëhequr jetën detare për miliona vjet.

Për organizmat detarë, alternimi natyror mes ditës dhe natës nuk është thjesht një çështje ndriçimi. Ai përfaqëson një mekanizëm jetik që rregullon ushqimin, riprodhimin, migrimin dhe ndërveprimet mes specieve. Kur errësira zëvendësohet nga ndriçimi artificial, këto procese biologjike fillojnë të çrregullohen.

Adriatiku, në krye të listës së rrezikut

Sipas një studimi ndërkombëtar të publikuar në revistën shkencore “Ocean & Coastal Management”, Adriatiku rezulton ndër zonat më të rrezikuara nga ndotja e dritës në Europë. Kërkimi u realizua nga shkencëtarë të Universitetit të Plymouth-it, Universitetit të Pizës dhe institutit italian ISPRA, në kuadër të projektit AquaPLAN.

Studiuesit zhvilluan një metodë të re për të vlerësuar nivelin e ekspozimit të ekosistemeve detare ndaj dritës artificiale gjatë natës. Analiza mori në konsideratë intensitetin e ndriçimit përgjatë brigjeve, transparencën e ujit dhe aftësinë e dritës për të depërtuar në shtresa të ndryshme detare. Rezultatet e vendosën Adriatikun në kategorinë më të lartë të rrezikut, përkrah Detit Baltik dhe Mesdheut Perëndimor.

Arsyeja është e qartë: Adriatiku është një det relativisht i mbyllur, i rrethuar nga brigje të populluara dendur dhe të zhvilluara ekonomikisht. Në veçanti, bregdeti italian paraqet një varg pothuajse të pandërprerë qytetesh, portesh, marinash turistike dhe qendrash pushimi, të cilat gjatë natës krijojnë një brez të vazhdueshëm ndriçimi.

Pasojat mbi jetën detare

Efektet e ndotjes së dritës nuk janë vetëm teorike. Shumë specie detare varen nga cikli natyror i errësirës për të kryer aktivitetet e tyre biologjike.

Planktoni, baza e zinxhirit ushqimor detar, kryen lëvizje vertikale të përditshme në varësi të dritës. Ndryshimi i këtij ritmi mund të ndikojë në të gjithë ekosistemin. Peshqit mund të ndryshojnë sjelljet e tyre të ushqimit dhe të migrimit, ndërsa raportet mes grabitqarëve dhe prenë mund të deformohen.

Një nga rastet më të njohura lidhet me breshkat detare. Të vegjlit që sapo dalin nga vezët orientohen natyrshëm drejt reflektimit të dritës mbi sipërfaqen e detit. Kur plazhet ndriçohen nga infrastruktura turistike dhe urbane, ata mund të humbasin drejtimin, duke rrezikuar mbijetesën e tyre që në momentet e para të jetës.

Shkencëtarët paralajmërojnë se ndikimi nuk kufizohet vetëm tek speciet individuale. Ndryshimet e vazhdueshme në sjelljen e organizmave mund të shkaktojnë pasoja në të gjithë rrjetin ekologjik, duke cenuar ekuilibrat e krijuar gjatë mijëra viteve.

Turizmi dhe zhvillimi përballë nevojës për mbrojtje

Paradoksi është se shumë nga burimet e kësaj ndotjeje lidhen me sektorë që janë themelorë për ekonominë e rajonit. Adriatiku është një nga zonat turistike më të rëndësishme të Mesdheut. Qytetet bregdetare investojnë çdo vit në ndriçim publik, pedonale, resorte dhe porte për të garantuar siguri dhe atraktivitet për vizitorët.

Megjithatë, ekspertët theksojnë se mbrojtja e errësirës natyrore nuk do të thotë domosdoshmërisht kthim pas në zhvillim. Përkundrazi, ata propozojnë një përdorim më inteligjent të ndriçimit: uljen e intensitetit të dritës, orientimin e burimeve ndriçuese në mënyrë që ato të mos shpërndahen drejt detit, fikjen e ndriçimit të panevojshëm gjatë orëve të vona dhe përdorimin e teknologjive më pak agresive për ekosistemet detare.

Një sfidë për politikat europiane

Publikimi i studimit vjen në një moment kur Bashkimi Europian po rivlerëson instrumentet e tij për mbrojtjen e mjedisit detar. Studiuesit argumentojnë se ndotja nga drita ka mbetur për shumë kohë jashtë vëmendjes së politikave mjedisore, pavarësisht provave në rritje mbi ndikimin e saj.

Sipas autorëve të kërkimit, mungesa e kritereve të qarta për vlerësimin e ndotjes së dritës në mjedisin detar ka bërë që ky fenomen të konsiderohet si një “kërcënim i fshehur”. Studimi synon të ofrojë bazën shkencore për përfshirjen e këtij faktori në strategjitë europiane të menaxhimit të deteve.

Të mbrosh edhe errësirën

Kur flitet për mbrojtjen e detit, zakonisht mendja shkon te cilësia e ujit, biodiversiteti ose mbetjet plastike. Por kërkimet e fundit sugjerojnë se edhe errësira është një burim natyror që duhet ruajtur.

Adriatiku, me brigjet e tij të mbipopulluara dhe ekonominë e mbështetur fuqishëm në turizëm, është bërë laboratori ku shihet më qartë përplasja mes zhvillimit njerëzor dhe nevojave të natyrës. Nëse deri dje shqetësimi kryesor ishte ndotja që hynte në det, sot shkencëtarët paralajmërojnë se edhe drita mund të jetë ndotës.

Sfida e viteve të ardhshme do të jetë gjetja e një ekuilibri mes nevojës për siguri, zhvillim ekonomik dhe mbrojtjes së ritmeve natyrore të jetës detare. Sepse, për shumë specie që jetojnë nën sipërfaqen e Adriatikut, errësira nuk është mungesë drite. Është kushti themelor për mbijetesë.

28 Nëntor 1443

Nga flamuri i lirisë te flamuri i Pavarësisë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

Nëntor 1912

Dita e Pavarësisë

Një 28 Nëntor, një amanet kombëtar

28

Dy data, dy epoka, një flamur dhe një komb

Gëzuar Festat e Nëntorit!